

SHABAN DEMIRAJ

RRETH DISA PROBLEMEVE TË PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE

Midis çështjeve problemore të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe ajo e paskajores është pa dyshim një ndër më të vështirat dhe njëherazi ndër më të rëndësishmet. Kjo çështje ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e gjuhëtarëve, sepse si në planin diakronik ashtu edhe në planin sinkronik ajo paraqit një sërë problemesh të ndërlikuara. Me aspektin diakronik të kësaj çështjeje janë marrë si albanistët ashtu edhe ballkanistët. Të parët janë përpjekur t'u japin përgjigje pyetjeve të tilla si a ka pasur shqipja e lashtë një paskajore të mirëfilltë, të krahasueshme për nga tipi strukturor me paskajoret e gjuhëve të tjera indoevropiane, si është krijuar forma e tipit *me ba* dhe a ka qenë kjo e mbarë shqipes etj. Kurse të dytët i ka preokupuar më fort sqarimi i dukurisë së zhdukjes së paskajores në shumicën e gjuhëve ballkanike si edhe dukuria e lindjes së një paskajoreje të dytë në gjuhët shqipe dhe rumanishtë.

Edhe problemet, që paraqit aspekti sinkronik i paskajores në gjuhën shqipe, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studjuesve të ndryshëm, sidomos të hartuesve të gramatikave. Një interes të veçantë ka ngjallur veçanërisht kategorizimi i togut të tipit *për të bërë*.

Kohët e fundit me disa probleme të paskajores së shqipes është marrë edhe gjuhëtari sovjetik M. A. Gabinski, i cili në vitin 1967 botoi edhe një vepër me titullin «*Lindja e paskajores si një proces gjuhësor ballkanik sekondar*»¹, që është mbështetur në materiale të gjuhës shqipe.

Duke qenë se pikëpamjet e gjuhëtarëve të ndryshëm mbi problemet themelore të paskajores në gjuhën shqipe janë kontradiktore dhe shpeshherë nuk i qëndrojnë dot kritikës, e pamë të arësveshme të shkruajmë këtë artikull, ku do të trajtohen këto çështje: 1) Çështja e zhdukjes së

1) *Voznikovenije infinitiva kak ftoričnyj ballkanski jazykovoju process*. Kjo vepër është botuar në Leningrad nga Akademia e Shkencave e Bashkimit Sovjetik dhe ka si redaktore përgjegjëse profesorëshën A.V. Desnickaja. Vepra ndahet në 3 kapituj, të ndjekur nga një përmbyllje prej 10 faqesh. Në kapitullin e parë, që shërben si një hyrje e përgjithshme për dy kapitujt e tjerë, autori parashtron pikëpamjet e veta mbi çështje të tilla si kriteret e dallimit të emrit dhe të paskajores, poligjeneza e lindjes së paskajores në gjuhët indoevropiane dhe monogjeneza e zhdukjes së saj në shumë gjuhë ballkanike, emrat e veprimit me origjinë participore në gjuhën shqipe, etj. Kapitulli i dytë i kushtohet shqyrtimit të formës së tipit *së bëri* (në togfjalëshë të tipit *mbarova së foluri, u lodha së foluri*), ndërsa kapitulli i tretë i kushtohet shqyrtimit të togut të tipit *për të bërë*. Këto studjohen në planin sinkronik, megjithëse nuk mungojnë aty-këtu edhe ekskurse historike, që në përgjithësi nuk janë të mbështetura me dokumentimet dhe argumentimet e nevojshme.

Autori ka shfrytëzuar një material faktik relativisht mjaft të pasur, të vjelë prej veprash letrare, shkollore e publicistike të paraluftës e të pasluftës (gjithsej 27.326 faqe). Por në shfrytëzimin e këtij materiali nuk është mbajtur gjithnjë një qëndrim kritik, që do ta kishte ndihmuar autorin të mbështetej vetëm në ato për-

paskajores në shumicën e gjuhëvet të Ballkanit; 2) kriteret e dallimit të paskajores së dytë në gjuhën shqipe: 3) rreth vlerës së tipit të tipit për të bërë: 4) rreth vlerës së formës së tipit të bërë. Në trajtimin e këtyre çështjeve po marrim si pikënisje për diskutim veprën e cituar të M.A. Gabinski, meqenëse problemet e paskajores së shqipes në atë vepër trajtohen gjërësisht dhe, veç kësaj, aty bëhen objekt kritike edhe shumë nga mendimet e gjuhëtarëve të tjerë. Një arsye tjetër, që na shtyti të marrim këtë vepër si pikënisje për diskutim, është se aty ka shumë mendime dhe interpretime, sipas nesh, të pambështetura e në mjaft raste edhe të pasakta.

I

CESHTJA E ZHUKJES SË PASKAJORES NË SHUMICËN E GJUHËVET
TË BALLKANIT

Në lidhje me zhdukjen e paskajores në shumicën e gjuhëvet të Ballkanit edhe sot nuk ka një mendim të vetëm të pranuar nga të gjithë. Megjithatë, është një fakt i njohur se pas botimit të veprës së Sandfeldit, «*Linguistique Balkanique*» (Paris, 1930), ka mbizotëruar mendimi se pikënisja e përhapjes së kësaj dukurie në gjuhët ballkanike duhet kërkuar në greqishten. Këtë mendim e ka mbrojtur kohët e fundit edhe gjuhëtari gjerman G. Rohlfs në artikullin «*La perdita dell'infinito nelle lingue balcaniche e nell'Italia meridionale*»². Por gjuhëtarë të tjerë para Sandfeldit, siç dihet, e kanë shpjeguar ndryshe pikënisjen e kësaj dukurie. P.sh., sipas G. Vaigandit (Balkan Archiv, I, f. X-XI), pikënisja duhet kërkuar në proto-shqipen, kurse dijetarë të tjerë kanë menduar për një zhvillim paralel të kësaj dukurie në gjuhët e Ballkanit.

Edhe M. A. Gabinski në veprën e cituar i kushton një vëmendje të veçantë çështjes së zhdukjes së paskajores në shumicën e gjuhëvet ballkanike, duke qenë se ai këtë e lidh tërthorazi edhe me atë të lindjes së paskajores së dytë në gjuhë të tilla ballkanike si shqipja dhe rumanishtja (f. 74).

Gabinski shprehet kundër pikëpamjes së gjuhëtarëve A. A. Potebnja, K. Mirçev, I. A. Boduen-de-Kurtene, P. Byrgierë (për gjuhët sllave jugore), P. Benesh, A. Graur, I. Baçinski, H. Bariç etj. (për rumanishten) (f. 36), të cilët burimin e kësaj dukurie në gjuhë të ndryshme të Ballkanit e kanë kërkuar në «paqartësinë», «abstraktësinë», «mungesën e shprehësisë» etj. të paskajores, pra jo në një burim të përbashkët me karakter ballkanik. Sipas autorit, kjo pikëpamje nuk mund t'i qëndrojë kritikës, të paktën, për dy arsye:

Së pari, vë në dukje ai, asnjë nga mbrojtësit e kësaj pikëpamjeje nuk e ka provuar me fakte konkrete epërsinë e ndërtimevet ballkanike

dorime, që janë përgjithësuar ose kanë prirje të përgjithësohen në gjuhën shqipe dhe, si rrjedhim, të linte mënjanë ato raste, që duket qartë se janë përdorime të izoluar të ndonjë autori të veçantë, si p.sh.: *njerëz të paditunë letra* (f. 62, shën. 3), *e hedhur sytë, e mbushëme mendjen* (f. 68), dhjetë dit pas mbarimit së ekzistuarit të Republikës spanjolle (f. 96), *Sapo mbaroi të treguari* ca kujtime (f. 134), *tuk me mbaruar dasmës* (f. 149) etj. etj. Madje, nganjëherë autori i shfrytëzon këto raste të pazakonshme përdorimesh të izoluar, për të mbështetur ndonjë pikëpamje të vetën.

2) Botuar në vëllimin «*Omagiu lui Jorgu Jordan*», Bukuresht, 1958 f. 733-744.

të tipit *dua të bëj* ndaj ndërtimit me paskajore të tipit *due me ba*. Në të dyja këto tipe konstruktesh veta dhe numri i vepruesit jepen nga folja drejtuese (në rastin konkret: *dua*), kështu që përsëritja e tyre me anë të formës së lidhore është pleonastike (f. 36-37). Nga ana tjetër, shton ai, do pasur parasysh se në gjuhët ballkanike vihet re prirja për mënjanimin e biflektivizmit tek disa folje me përdorim shumë të dëndur. Këtë dukuri ai e argumenton me ndërtimet e tipit shqip *duhet të bëj*, rumanisht *trebuie să fac*, greqisht *πρέπει να κάνω*, ku folja modale përdoret si pavetore. Sipas tij, te kjo prirje e ka burimin edhe formimi i së ardhmes (e më rrallë edhe i kushtores) me foljen *do* në disa gjuhë të Ballkanit, duke përfshirë edhe shqipen (f. 37). Me këtë rast ai përmend edhe togfjalëshin e shqipes *mund të bëj*, ku folja modale *mund* përdoret në një formë të ngurosur. Si rrjedhim, zëvendësimin e paskajores me lidhoren Gabinski e gjen në kundërshtim me prirjen ballkanike për mënjanimin e biflektivizmit.

Së dyti, pyet ai, përse prirja për zëvendësimin e paskajores me lidhoren për të dhënë «informacion të bollshëm» është zhvilluar vetëm në gjuhët e Ballkanit dhe asgjëkund gjetkë? (f. 37-38).

Për sa i takon argumentit të parë, që paraqit Gabinski kundër atyre që mbrojnë origjinën jo të përbashkët të zhdukjes së paskajores në shumicën e gjuhëve ballkanike, nuk mund të mos bëhen vërejtjet e mëposhtme:

1) Ndërtimi i tipit *due me ba* nuk ka ndonjë «paqartësi» në krahasim me ndërtimin e tipit *dua të bëj* vetëm atëhere kur si folja e parë ashtu edhe e dyta kanë të bëjnë me të njëjtën kryefjalë. Por, kur folja e dytë ka një kryefjalë të ndryshme nga ajo e foljes së parë, atëhere ndërtimi i tipit *Unë dua që ti të jesh i sjellshëm* del pa tjetër më i qartë dhe më i përcaktuar se ndërtimi sinonim me paskajoren. Për këtë arsye, në të gjitha gjuhët neolatine në raste të tilla ndërtimi i kallëzores me paskajore në latinishtes³, është zëvendësuar gjithandej me ndërtimin me lidhoren.

2) Mendimi se në gjuhët ballkanike vihet re prirja për mënjanimin e biflektivizmit, mund të shërbente për të mbështetur pikëpamjen e Gabinskit, në rast se ai do të kish provuar më parë se kjo prirje është më e vjetër se zëvendësimi i paskajores me lidhoren dhe se dukuria e fundit është përfutur në kundërshtim me prirjen në fjalë. Përndryshe, ky argument nuk ka ndonjë vlerë për të kundërshtuar tezën që ai kërkoi të hedhë poshtë. Historia e gjuhëve indoevropiane na tregon se në etapa të ndryshme të zhvillimit të një gjuhe mund të vërtetohen edhe prirje të kundërta. Mjafton të kemi parasysh faktin e njohur që gjuhët indoevropiane në një periudhë shumë të lashtë kanë pasur shumë të zhvilluar karakterin sintetik, kurse me kalimin e kohës ato kanë zhvilluar edhe karakterin analitik⁴. Ose le të marrim një shembëll tjetër. Po të pranojmë mendimin që dy gjuhë ballkanike si rumanishtja dhe shqipja në një periudhë të mëparshme të zhvillimit të tyre (në mënyrë të pavarur apo nën ndikimin e një shkakut të përbashkët) e kanë zëvendësuar paskajoren me lidhoren⁵, kurse në një periudhë të mëvonshme

3) Edhe në latinishte, në raste të tilla, mund të përdorej ndërtimi me lidhoren (shih Giovanni Zenoni, *La sintassi latina*, 1932, f. 226).

4) Shih, ndër të tjera, A. Meillet, *Introduction à l'étude comparative des langues indoeuropéennes*, 7e éd. 1934, f. 437 v.

5) Gabinski mendon se dukuria e zëvendësimit të paskajores me lidhoren është vërtetuar vetëm në toskërishte (shih më tutje).

kanë ndjerë nevojën të krijojnë paskajore të dyta, të cilat në një farë mase zëvendësojnë lidhoren, atëhere edhe në këtë rast kemi të bëjmë me dy prirje të kundërta.

3) Lidhur me rastet, që përmend Gabinski për të vërtetuar prirjen e gjuhëvet ballkanike për të mënjeluar biflektivizmin, do vërejtur:

a) Para se të pohohej se tek ndërtimet e tipit *duhet të bëj, trebuie să fac*, *πρέπει να κάνω* folja modale përdoret si pavetore si rrjedhim i prirjes për të mënjeluar biflektivizmin, duhej vërtetuar se në këto gjuhë ajo më parë është përdorur me të njëjtin kuptim modal edhe si folje vetore. Por lidhur me këtë dukuri të kihet parasysh se folje pavetore me një kuptim të tillë modal janë përfutur edhe në disa gjuhë të tjera, ku s'paraqitet nevoja për mënjanim biflektivizmi. Mund të përmenden, sa për shembëll, konstruktet frenge dhe italiane të tipit *il faut faire, bisogna fare*, ku foljet pavetore me kuptim modal ndiqen nga paskajorja.

b) Përsa i takon ndërtimit të tipit *s'mund të bëj*, ku folja modale paraqitet e ngurosur, do pasur parasysh se kjo ngurosje ndodh vetëm atëherë kur folja modale përdoret me vlerën e kohës së tashme dhe të së pakryerës d.m.th. vetëm atëherë kur shqiptohet e mbërthyer me foljen ndjekëse. Në raste të tjera, ajo përdoret me format flektive të zgjedhimit vepror⁶. P.sh. nuk munda të vija me kohë: S'kam mundur ta përfundoj, sepse...

c) Edhe për formimin e së ardhmes (dhe të kushtores)⁷ me anë të foljes së ngurosur shqip *do*, greqisht *θα* (< *θέλει να*) etj.⁸ të ndjekur nga format flektive të së tashmes (përkatësisht të së pakryerës) lidhore, do pasur parasysh se mënjanimi i biflektivizmit nëpërmjet ngurosjes së foljes *dua* (gr. *θέλει*) ka qënë pasoja e nevojës për të dalluar formalisht togun e gramatikalizuar me vlerë së ardhmeje (përkatësisht kushtoreje) nga togjet e lira të tipit shqip *dua të bëj, do të bëjë etj.*, gr. *θέλω να κάνω, θέλει να κάνει* etj. Në këtë rast një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe dobësimi, përkatësisht humbja e theksit tek komponentja e parë e së ardhmes.

* * *

Përsa i takon argumentit të dytë, që sjell Gabinski kundër tezës së poligjenezës së zhdukjes së paskajores në gjuhët ballkanike, do pasur parasysh se, sikurse e kanë vënë në dukje edhe të tjerë para tij⁹, kjo dukuri është vërtetuar edhe në disa të folme të Italisë Jugore, pra, edhe jashtë kufinjve të Ballkanit.

6) Folja *mundem*, si modale, në të kryerën e thjeshtë dhe në kohët e përbëra zgjedhohet si foljet veprorë, kurse në të tashmen dhe në të pakryerën, kur nuk është e ngurosur, zgjedhohet si foljet e diatezës pësore-vetëvetore. Nga kjo pikëpamje ajo i ngjan foljes *mbetem*.

7) Është fjala për formën përfirastike të tipit *do të bëja*, e cila (ashtu si format e tipit *kisha me ba a kisha për të bërë*) në shqipen e sotme kryen edhe funksionin e së ardhmes në të shkuarën edhe atë të kushtores (shih *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, dispensë, II, 214-216).

8) Sipas Sandfeldit, *Ling. Balk.*, 182, ky tip i së ardhmes është sajuar edhe në bullgarishten (p.sh. *šte da pisā*) si edhe në rumanishten (p.sh. *o să scriu*, ku *o* < *va*, v. III njëjës e foljes *voiu*). Por në gramatikat e rumanishtes jepet tipi tjetër i së ardhmes, i formuar nga format vetore (të shkurtuara) të foljes ndihmëse *voiu* (*voi, vei, va* etj.) të ndjekura nga paskajorja e foljes themelore.

9) Shih G. Rohlfs, *La perdita dell'infinito nelle lingue balcaniche e nell'Italia meridionale*, f 733.

* * *

Gabinski kritikon me të drejtë (f. 40-41) pikëpamjen e Miklosiçit, sipas së cilës paskajorja në greqishte dhe në bullgarishte është zhdukur si rrjedhim i homonimisë së krijuar midis paskajores (pas rënjes së tingullit fundor, gr. -ν, bullg. -u) dhe vetës së tretë njëjës së kohës së tashme. Përveç argumentave të parashtruar nga Iliev dhe Mirçev kundër kësaj hipoteze për bullgarishten, autori vëren me të drejtë se, po të ishte i drejtë shpjegimi i Miklosiçit, një dukuri e tillë duhej të kish ndodhur edhe në gjuhë të tjera si portugalishtja, frengjishtja, gjermanishtja, etj., ku nuk janë të rralla rastet e homonimisë së paskajores me ndonjë formë vetore të foljes.

* * *

Gabinski nuk pranon as hipotezën shumë të përhapur mbi rolin e greqishtes në zhdukjen e paskajores në një sërë gjuhësh të Ballkanit (f. 42 v.)¹⁰. Siç u vu në dukje edhe pak më sipër, ai nuk e pranon as mendimin e Miklosiçit që paskajorja në greqishte të jetë zhdukur (pas rënjes së pretenduar të fundores -ν) si rrjedhim i homonimisë me formën e vetës së tretë njëjës të kohës së tashme. Nga gjashtë argumentat, që ai sjell me këtë rast, vlejné të përmenden sidomos argumenti i dytë (që homonimia nuk ka shkaktuar një dukuri të tillë në gjuhë të tjera) dhe i gjashti (që funksioni gramatikor duhej ta kishte ruajtur fundoren -ν të paskajores, aq më tepër kur në greqishte është zhvilluar me kohë edhe prirja për të shtuar në raste të ngjashme një -ε pas fundores -ν, si p.sh. τόνε λένε etj.). Gjithashtu ai vëren se në të folmet greke të Pontit e Trapezundës fundorja -ν e paskajores është ruajtur, por paskajorja, megjithatë, përdoret në mënyrë shumë të kufizuar; e këtë pakësim të përdorimit të paskajores në ato të folme autori e shpjegon si rrjedhim të ndikimit të të folmevet greke të vetë Greqisë.

Sipas Gabinskit, të dhënat e gjeografisë gjuhësore nuk e vërtetojnë mendimin e Kapidanit, Sandfeldit, Gizes (Giese), Rohlfisit, Vulpes etj. mbi origjinën greke të zhdukjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit (f. 46). Ai vëren me të drejtë se gegërishtja, e cila ndodhet «shumë më afër Greqisë se një pjesë e madhe e arealeve të sllavishtes jugore dhe të dakorumanishtes», e ka ruajtur mirë paskajoren (f. 46). Ai shton edhe disa argumenta të tjerë, nga të cilët po përmendim:

Në meglenishte, edhe në truallin e vetë Greqisë, është ruajtur paskajorja pas foljes «mund». Edhe në të folmet sefarde të Ballkanit, duke përfshirë edhe ato të Greqisë, ruhet mirë paskajorja, me gjithë ndikimet që ato të folme kanë pësuar nga gjuhët fqinje. Edhe në Itali, sipas autorit, zhdukja e paskajores është kufizuar vetëm në viset e substratit grek (shih më poshtë).

Tezën e vet kundër origjinës greke të zhdukjes së paskajores në gjuhët ballkanike Gabinski e mbron edhe me një argument tjetër. Ai shënon (f. 48) se epërsia kulturele e greqishtes në këtë rast nuk është një

10) Rolin e greqishtes e pranon vetëm për toskërishten, për gjuhën e ciganëvet dhe për tri nëndialekte të Italisë Jugore (f. 48). Por, ndërsa zhdukjen e paskajores në toskërishte dhe në 3 nëndialekte të Italisë Jugore autori e shpjegon me ndikimin e substratit grek, për të njëjtën dukuri në gjuhën e ciganëvet ai nuk është shprehur shkoqur.

faktor relevant, gjersa është fjala për një dukuri, «që nuk ka lidhje me specifikën e sferave më të larta të marrëdhënjeve».

Ne do të shtonim se ndikimi i greqishtes mbi gjuhët e Ballkanit, përsa i takon strukturës gramatikore, në përgjithësi është mbivlerësuar. Në rastin konkret mbrojtësit e tezës se në gjuhët e Ballkanit paskajorja është zhdukur nën ndikimin e greqishtes, nisen nga premisa se greqishtja si gjuhë kulture dhe kishëtare ka pasur një pozitë dominuese në Ballkan. Mirëpo, po të kihet parasysh karakteri popullor i kësaj dukurie si edhe përhapja e saj e gjërë në Ballkan, ky argument nuk duket bindës, sepse është e vështirë, në mos e pamundur, që ndikimi i kësaj gjuhe «dominuese» të ketë depërtuar kaq thellë në masat e gjëra të popujvet ballkanikë, për të cilët greqishtja si gjuhë e huaj ishte e panjohur. Nga ana tjetër, edhe shkaku i zhdukjes së paskajores në vetë gjuhën greke mbetet i paqartë. Ne bashkohemi me vërejtjet e Gabinskit që shpjegimi i Miklosiçit mbi zhdukjen e paskajores në greqishte nuk është bindës.

* * *

Në bazë të të dhënave gjeografike Gabinski mendon se burimi i mundshëm i zhdukjes së paskajores duhet kërkuar «në ndonjë gjuhë të vjetër të pjesës juglindore të Ballkanit, d.m.th. në një nga varietetet e trakishtes» (f. 46-47). Sipas tij, «trakishtja (ose dakomizishtja, një gjuhë fa-refis shumë e afërt me të) mund të konsiderohet si një gjuhë, që s'e ka pasur paskajoren, në rast se vërtetohen dy hipotezat e kohëvet të fundit, që janë të lidhura pandërmjetshëm me albanistikën».

«Së pari, po të provohet hipoteza e V. Georgievit që shqipja është vazhduesja jo e trakishtes në përgjithësi (siç e mendonte V. Deçevi, të cilin V. Georgievi e saktëson), por pikërisht e dakomizishtes.»

«Së dyti, për të provuar mungesën e paskajores në gjuhën në shqyrtim të Ballkanit lindor, duhet të vërtetohet hipoteza...¹¹, sipas së cilës tipi *me ba* është një përcjellore e dikurshme, që historikisht zërthehet në parafjalën e shoqërimit *me* dhe në emrin prejparticipor të veprimit, ende të papajisur me nyjen proklitike, d.m.th. një fakt me një zanafillë relativisht jo të vjetër. Duke llogaritur që *me ba / me bënë* në zanafillë është një formim i mbarë shqipes... dhe që, me gjithë përpjekjet e bëra, ndonjë paskajore më e vjetër e shqipes nuk është gjetur, proto-shqipja paraqitet si një gjuhë pa paskajore» (f. 47-48).

Dhe autori përfundon: «Në qoftë se, në këtë mënyrë, kjo gjuhë rezulton të jetë dakomizishtja ose një tjetër degëzim i trakishtes, atëherë substrati si burim i humbjes së paskajores në Ballkan mund të konsiderohet i lokalizuar» (f. 48).

Siç shihet, ky mendim i M. A. Gabinskit, i cili në thelb i ngjan shumë atij që ka shprehur Gustav Vaigandi që në vitin 1925¹², niset nga disa hipoteza të pavërtetuara, prandaj është shkencërisht i pambrojtshëm.

Hipoteza e Georgievit, e cila në të vërtetë është një përpjekje «për të saktësuar» më tej mendimin e shprehur më parë nga Vaigandi¹³, Deçevi

11) Një hipotezë të tillë autori e paska bërë që në artikullin **об инфинитивности в албанском языке**. Уч. зап. (Институт языка и литературы), Кишинев, т.х, 1961, f. 62-63.

12) Shih «Balkan Archiv», I, 1925, f. X-XI.

13) Shih artikullin *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder der Thraker?*, botuar në «Balkan-Archiv», III, 1927, f. 227-251.

etj. mbetet edhe sot e gjithë ditën një hipotezë, historikisht dhe gjuhësisht e pambështetur. Kundër argumentavet të Vaigandit, e si rrjedhim, edhe të Georgievit është shprehur, sipas nesh, në mënyrë bindëse E. Çabej në artikujt «*Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*»¹⁴ dhe «*Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund*»¹⁵. Ne mendojmë se edhe krahasimi, që bën Georgievi midis sistemit fonetik të shqipes së vjetër dhe sistemit fonetik të së ashtuquajturës dakomizishte, nuk i qëndron dot kritikës, pasi duket si diçka e ndërtuar nergut për të mbrojtur një tezë të pranuar që më parë¹⁶.

Edhe hipoteza e dytë e M.A. Gabinskiit që protoshqipja nuk ka pasur paskajore (f. 48), duke e «argumentuar» me jo më pak se tri hipoteza të tjera, mbetet e pambrojtshme. Më parë ai duhej të vërtetonte se forma foljore perifrastike e tipit *me ba* në zanafillë ka qenë përcjellore, se ajo ka qenë një formë foljore e mbarë shqipes dhe se toskërishtja e ka humbur këtë paskajore perifrastike nën ndikimin e greqishtes, apo, siç shprehet ai, nën ndikimin e «substratit grek» (sic!) (f. 48). Gjithashtu autori duhej ta përcaktonte disi më mirë kohën e zanafillës së kësaj forme foljore perifrastike në mbarë shqipen, sepse shprehja «me një zanafillë relativisht jo të vjetër» (f. 47) nuk sqaron gjë në këtë mes. Veç kësaj, Gabinski, i cili mendon se protoshqipja s'duhet të ketë pasur paskajore, duhej të sqaronte edhe arësyen përse vazhduesja e saj, shqipja, paska ndërjerë nevojën të krijonte në fillim një paskajore të parë të tipit *me ba*, me origjinë përcjelloreje (sic!), e më vonë edhe jo më pak se dy paskajore të dyta, të cilat, sipas tij, në gjendjen e sotme janë in statu nascendi¹⁷.

* * *

Në kundërshtim me Hanin, Majerin, Sandfeldin, etj., disa gjuhëtarë të tjerë si Pedersen, Pekmezi, Jokli, La Piana e Çabej kanë shprehur mendimin se shqipja dikur ka pasur një paskajore të mirëfilltë.

Pedersen në recensionin e veprës së Kr. Sandfeld-Jensen, *Rumaenske Studier I*, botuar në IF, 12, Anzeiger, (f. 91-93), duke u nisur nga premisa se mbarë shqipja duhet të ketë pasur një paskajore të mirëfilltë (f. 92), shkruan: «Identiteti formal i paskajores, që pas këtyre diskutimeve është për t'u pranuar si e mbarë shqipes, me pjesoren e kryer pësore, mund të jetë fare mirë sekundar. Sepse, siç dihet, prapashtesa, pjesa përbërëse

14) Botuar në «BUSHT, SShSh», 2, 1958, 54-62.

15) Botuar në *Les problèmes fondamentaux de la linguistique balkanique* (Rapport pour la séance plénière du I^{er} Congrès int. des Etudes Balk. et Sud-Est Européennes) Sofia, 1966, f. 47-55.

16) Edhe krahasimet, që bën Georgievi midis sistemit fonetik të protoshqipes dhe atij të së ashtuquajturës dakomizishte (shih *Albanisch, Dakisch-Mysisch und Rumänisch, Die Herkunft der Albaner*, në «Linguistique Balkanique», II, Sofia, 1960, f. 1-19) na duken të paargumentuara në mënyrë bindëse. Në këtë artikull ne nuk i kemi vënë vetes si detyrë të merremi me këtë çështje, prandaj do të kufizohemi vetëm me një vërejtje parimore: Refleksi (a reflekset) i një tingulli indoeuropian në një gjuhë të dhënë nuk mund të përcaktohet duke u mbështetur në disa shembëlla të rastit dhe pa marrë parasysh caqet kohore, në të cilat janë vërtetuar ndryshimet, që ka pësuar ai tingull gjatë evolucionit të tij. Neve na rezultoi se kjo gjë nuk është pasur parasysh sa duhet në artikullin e cituar të Georgievit.

17) Është fjala për formën e tipit *së bëri* (në togfjalësha të tipit *mbarova së foluri*) dhe për togun e verbalizuar të tipit *për të bërë*; për këto do të bëhet fjalë më tutje.

më thelbësore e të cilavet është *-n-* ose *-m-*, në gjuhët indoevropiane përdoren si në ndërtim paskajoresh ashtu edhe pjesoresh. Prandaj identiteti i paskajores me pjesoren në gjuhën shqipe në origjinë ndoshta nuk ishte më intim se identiteti i paskajores *geschehen* me pjesoren *geschehen*. Në të mirë të këtij shpjegimi flet edhe rrethana që gjuha fqinje e shqipes, greqishtja, përdor gjithashtu prapashtesa me *-n-* dhe *-m-* në paskajore».

Këto supozime të Pedersenit që shqipja e lashtë të ketë pasur një paskajore të mirëfilltë, që identiteti formal i asaj paskajoreje me pjesoren e kryer pësore mund të jetë sekundar dhe që ky identitet në gjuhën shqipe «ndofta nuk është më intim se identiteti i paskajores *geschehen* me pjesoren *geschehen*» në gjermanishte, mbeten supozime, që, në mungesë faktesh gjuhësore më të lashta nga ato që disponojmë për gjuhën shqipe, as mund të vërtetohen, as mund të hidhen poshtë në mënyrë kategorike¹⁸.

Si rrjedhim, edhe supozimi tjetër i Pedersenit që «paskajorja e shqipes para së gjithash është zhdukur krejtësisht dhe vetëm më vonë është zëvendësuar me pjesoren» (f. 92), ashtu sikurse edhe mendimi i E. Çabejt që «shqipja e ka humbur që heret infinitivin e trashëguar nga koha indoevropiane¹⁹ dhe më vonë ka krijuar një të ri» («*Betrachtungen über die rumänisch-albanischen Sprachbeziehungen*», në RRL, X, N. 1-3, f. 108), mbeten supozime të paargumentuara, që mbështeten vetëm në hipotezën se shqipja ka pasur dikur një paskajore të mirëfilltë.

Përsa i takon mendimit të Pedersenit që «paskajorja duhet të ketë ekzistuar edhe në shqipen jugore, siç rezulton nga reliktet si pa *pasurë*» (f. 92)²⁰, do thënë se këtu nuk kemi të bëjmë me një formë të trashëguar foljore me vlerë paskajoreje, ashtu siç mendonte Pedersenit, miratuar edhe nga Jokli («*Litteris*», IV, Nr. 3, 1927, 206-207).

Edhe mendimi i Joklit («*Litteris*», IV, Nr. 3, 207), miratuar edhe nga Sandfeldi (Ling. Balk., 132), që në togfjalëshat e mbarë shqipes të tipit *duhet ditë* gjymtyra e dytë është një paskajore pa *me*, nuk është i mbë-

18) Me sa duket, më vonë Pedersenit duhet ta ketë ndryshuar mendimin mbi karakterin sekondar të identitetit formal të paskajores me pjesoren e kryer pësore në gjuhën shqipe. Në artikullin *Die Gutturale im Albanesischen*, botuar në KZ, 36, f. 288, ai shkruan: «...ashtu si për *digjem*, *vidhem* etj., forma veprore *djeg*, *vjedh* etj., pjesorja e kryer pësore (që në shqipen veriore kryen funksionin edhe si paskajore) është *djegë*, *vjedhë*, kështu edhe për *dirsem* u ndërtua paskajorja *djers*. «...wie nun zu *digjem*, *vidhem*, u.s.w. das aktivum *djeg* ('brenne') *vjedh* ('stehle') u.s.w., das partizipium perf. pass. (im Nordalbanesischen auch als infinitiv fungierend) *djegë*, *vjedhë* heisst, so wurde zu *dirsem* der infinitiv *djers* gebildet.»

19) E. Çabej e ka fjalën për një paskajore të krahasueshme për nga tipi strukturor me paskajoret sufiksale, që janë zhvilluar që heret në shumicën e gjuhëve indoevropiane. Por shprehja «infinitivin e trashëguar që nga koha indoevropiane» ka nevojë për saktësim.

20) Mendimi që forma (pa) *pasurë* ka vlerën e paskajores është pranuar edhe në *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë), II, 234 v., hartuar nga shkruesi i këtyre radhëve, i cili nuk i përmbahet më këtij mendimi. Në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me një formë të pashtjellë foljore, të sajuar nga pjesëza parafjalore *pa* dhe pjesorja (më saktë, pjesorja e substantivuar) e kryer pësore. Funksionet e kësaj forme të pashtjellë foljore (shih dispensën e cituar, II, 239) nuk janë karakteristike për paskajoren. Ne mendojmë se në planin sinkronik tipi *pa pasurë* duhet trajtuar si një formë perifrastike foljore, dhe jo si një tog i përbërë prej dy fjalësh. Lidhja midis të dy pjesëve të përbërëse të saj është bërë aq e ngushtë, sa që ka krijuar mundësinë që ajo të përdoret edhe në formën e diatezës pësore-vetëvetore të tipit *pa u larë* e aty këtu edhe në kohën e kryer të tipit *pa pasë punuar*; (format *u larë* dhe *pasë punuar*, të shkëputura, nuk ekzistojnë në gjuhë). Kjo formë perifrastike, që për nga tipi strukturor nuk ka shembëll në asnjë gjuhë tjetër, meriton një studim të veçantë.

shtetur²¹. Në këtë tip togfjalëshi gjymtyra e dytë, kur folja është kalimtare, ka kuptim pësor, ashtu si pjesorja e shkuar. Kjo duket qartë, po të kihet parasysh se në ndërtimet e këtij tipi s'mund të përdoret kurrë një kundrinë e drejtë, si edhe po të krahasohen ato me ndërtimet geqe të tipit *duhet me e krye atë punë*, ku përdorimi i kundrinës së drejtë është krejt i natyrshëm, kur folja në paskajore është kalimtare veprore.

I pambështetur na duket edhe mendimi i Pekmezit (Grammatik, 194) që forma participore më e shkurtër (e tipit *dalë, marrë, punue* etj.) «është një shkurtim i një paskajoreje origjinare, që sot ka humbur». Për nga kuptimi, këto forma nuk kanë asnjë ndryshim prej formave participore më të plota. Ato janë përfutur gjatë evolucionit historik të shqipes si pasojë e asimilimit të disa grupeve bashkëtingëlloresh (-1n-, -rn- etj., si p.sh. *dalë, vjelë, marrë* etj.) ose si pasojë e analogjisë (p.sh. *hapë, djegë* etj.)²², ose janë përfutur nga rënja e tingullit fundor që shërbente si mbaresë trajtëformuese (p.sh. *punue*, tek autorët e vjetër *punuem*).

Pra, për mungesën, përkatësisht për ekzistencën e një paskajoreje më të lashtë të shqipes, të krahasueshme për nga tipi strukturor me paskajoret e simotravet të saj indoevropiane, nuk mund të bëhen pohime kategorike, përderisa materialet ekzistuese nuk na lejojnë të arrijmë në një përfundim të sigurtë. Në rast se shqipja ka pasur një paskajore më të lashtë se ajo e tipit *me ba*, siç pohojnë Pedersen dhe Çabej, atëherë duhet sqaruar përse dhe kur është zhdukur ajo, si edhe përse e kur është krijuar ndërtimi participor i tipit *me ba* me vlerën e paskajores. Anasjelltas, në rast se shqipja nuk ka pasur ndonjë paskajore të tillë të lashtë, siç pohojnë Hani, Majeri, Sandfeldi, Gabinski etj., atëherë duhet sqaruar përse, kur dhe si është krijuar paskajorja e tipit *me ba*, a ka ekzistuar kjo edhe në toskërisht dhe, në rast se po, përse është zhdukur në atë dialekt.

Siç shihet, çështja e paskajores në gjuhën shqipe paraqitet shumë e ndërlikuar. Në të tilla rrethana çdo hipotezë duhet të peshohet mirë, duke u mbështetur në prirjen e përgjithshme të zhvillimit historik të gjuhës shqipe në këtë fushë. Lidhur me këtë bien në sy:

1) Që shumë shekuj përpara botimit të librit të parë shqip (1555), që njohim gjer më sot, të paktën gegërishtja²³ ka krijuar formën e pashtjellë foljore të tipit *me ba* me vlerën e paskajores.

2) Siç e kemi shtjelluar edhe më parë²⁴, në një periudhë më të vonë mbarë shqipja ka krijuar formën e pashtjellë foljore të tipit *për të bërë / për të ba(m)* me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara.

3) Forma perifrastike e tipit *me ba* është sinonime me mënyrën lidhore (të shoqëruar ose jo me lidhëza nënrenditëse) në shumicën e funk-

21) Ky tip togfjalësh i për nga tipi strukturor është i krahasueshëm me togfjalëshin rumun të tipit *trebuie făcut*, ku gjymtyra e dytë gjithashtu nuk është paskajore, por pjesore e kryer pësore (një pjesë e madhe e gjuhëtarëve rumunë e quajnë atë, sipas mendimit tonë pa të drejtë, supin).

22) Shih G. Meyer, *Kurzgefasste alb. Grammatik*, 42-43.

23) Nuk përjashtohet mundësia që atë ta këtë pasur dikur edhe toskërishtja, por kjo hipotezë mbetet e paargumentuar sa duhet.

24) Shih kumtesën tonë *Forma grammatikore perifrastike për + emër foljor i gjinisë asnjansë në trajtë të pashquar*, në vëllimin «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë, 1965, f. 213-220.

sionevet të saj. Edhe forma perifrastike e tipit *për të bërë* është sinonime me mënyrën lidhore në disa nga funksionet e kësaj.

Po të kihen parasysh këto fakte²⁵, atëherë nuk është vështirë të nxirren këto përfundime:

1) Në rast se shqipja nuk ka pasur një paskajore më të vjetër se ajo e tipit *me ba*, atëherë as që mund të bëhet fjalë për zhdukjen e paskajores në këtë gjuhë, por përkundrazi duhet folur për zëvendësimin e pjesshëm të lidhores me anë formash perifrastike me vlerë paskajoreje. Në rast se paskajorja e tipit *me ba* nuk ka ekzistuar në toskërishte, ky zëvendësim i pjesshëm i lidhores në një periudhë të hershme do t'i takonte vetëm gegërishtes.

2) Në rast se pranojmë hipotezën, që mbrohet edhe nga Gabinski, se paskajoren e tipit *me ba* e ka pasur edhe toskërishtja, atëherë duhet të pranojmë se në këtë dialekt në një periudhë më të vjetër është vërtetuar prirja e zëvendësimit të saj të plotë me lidhoren, kurse në një periudhë më të vonë është vërtetuar prirja e kundërt e zëvendësimit të pjesshëm të lidhores nga forma e pashtjellë e tipit *për të bërë*.

Në të tilla rrethana duket më e mundshme që paskajorja e tipit *me ba* të ketë zëvendësuar një paskajore më të vjetër, e cila duhet të jetë zhdukur që heret pa lënë gjurmë. Ne anojmë nga kjo hipotezë, duke u mbështetur në faktin që në një kohë, kur në disa gjuhë ballkanike paskajorja ka ardhur duke u zhdukur, në një nga dialektet e shqipes ajo (është fjala për paskajoren e tipit *me ba*) ka qenë shumë e gjallë, ndërsa në një periudhë më të vonë mbarë shqipja (sidomos toskërishtja) ka krijuar një formë foljore perifrastike (të tipit *për të bërë*), e cila, siç do ta shtjellojmë edhe pak më tutje, përdoret në një numër funksionesh sintaksore, që janë karakteristike për paskajoren. Këto forma të pashtjella (të tipit *me ba* dhe *për të bërë*), me origjinë participore por me vlerë infinitivale, sipas mendimit tonë, nuk mund të ishin krijuar në një gjuhë, për bartësit e së cilës do të kishte qenë e huaj ndjenja e paskajores.

Sidoqoftë, edhe në rast se mbarë shqipja ka pasur dikur një paskajore më të vjetër, të krahasueshme për nga tipi strukturor me ato të simotravet të saj indoevropiane, prapë mbetet për të sqaruar përse dhe kur është zhdukur ajo, siedhe përse, kur dhe si është krijuar forma me origjinë participore e tipit *me ba*.

* * *

Forma perifrastike e tipit *me ba* nuk na rezulton të ketë qenë në zanafillë një përcjellore, siç pretendon Gabinski (f. 48). Me vlerën e përcjellores mbarë shqipja ka krijuar prej kohësh formën perifrastike të tipit *tue ba* (m) / *duke bërë*, e cila në disa nga funksionet sintaksore takohet edhe me pjesoren e tashme të gjuhëve të tjera indoevropiane²⁶. Të

25) Përveç formave perifrastike të lartpërmendura edhe forma e tipit *pa pasur* në funksionet kohor dhe kushtor është sinonime me lidhoren e paraprirë nga ndonjë lidhëz kohore e kushtore. Edhe ndërtimet participore të tipit *me të ardhur* (në shqipen popullore edhe *një të ardhur*), kur folja drejtuese është në kohën e ardhme ose në urdhërore, janë sinonime me lidhoren e paraprirë nga ndonjë lidhëz kohore.

26) Megjithatë, ashtu si A. Xhuvani («Buletin për Shkencat Shoqërore», II 1953, 51, edhe ne nuk pajtohemi me mendimin e W. Cimochovskit (*Le dialecte de Dushmani*, 1951), i cili formën perifrastike të tipit *tue bâ* e quan pjesore e tashme (f. 120-121).

paktën që nga shek. XVI e këtej si në gegërishten e shkruar ashtu edhe në të folurën forma në shqyrtim (*me ba*) nuk haset gjëkund qoftë edhe në një funksion të vetëm përcjellorjeje. Si tek autorët e vjetër veriorë ashtu edhe më vonë ajo përdoret vetëm në ato funksione sintaksore, që janë karakteristike për paskajoren. Por kuptohet vetiu që kjo formë e pashtjellë foljore me vlerë paskajoreje duhet të jetë mjaft më e vjetër se shekulli i Buzukut (shek. XVI). Ajo do të dilte shumë më e vjetër, po të vërtetohej se ka qenë e mbarë shqipes, ashtu siç mendonte La Piana dhe siç mendon tashti edhe Gabinski²⁷. Ndryshe mendon për këtë E. Çabej, i cili në «*Betrachtungen über die rumänisch-albanischen Sprachbeziehungen*», f. 108 thotë se paskajorja e tipit *me ba* nuk ka qenë e mbarë shqipes, por vetëm e gegërishtes.

Ekzistenca, përkatësisht mosekzistenca e paskajores së tipit *me ba* në toskërishte në të kaluarën është një çështje, që duhet sqaruar, para se të mund të flitet për zhdukjen e saj në atë dialekt. Shumica e atyre që kanë shprehur mendimin se toskërishtja e ka humbur paskajoren, janë nisur nga premisa që paskajorja e tipit *me ba* ka ekzistuar edhe në atë dialekt²⁸. Kështu mendon, p.sh., Marko La Piana, i cili ka shprehur mendimin se humbja e paskajores në toskërishte s'duhet shpjeguar si ndikim i greqishtes mbi atë dialekt, por si një evolucion paralel i pavarur në greqishte e në shqipe, me gjallërimin e madh të ndërtimevet me lidhoren²⁹.

Kështu mendon edhe G. Rohlfsi, i cili në artikullin «*La perdita dell'infinito nelle lingue balcaniche e nell'Italia meridionale*»³⁰, ku zanafillën e humbjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit e sheh tek greqishtja, shkruan: «Për Shqipërinë Jugore, ku paskajorja nuk ekziston më, në mungesë tekstesh më të hershme, asgjë s'mund të përcaktohet, por duket se kjo e folme e ka mënjeluar paskajoren pak a shumë në të njëjtën periudhë, në të cilën barinjët sllavë e rumunë të Maqedonisë i dhanë preferencë përdorimit të ri [me lidhoren — Sh. D.]»³¹.

Edhe Gabinski humbjen e paskajores në toskërishten e shpjegon si një ndikim të greqishtes. Por ndryshe nga Rohlfsi³², i cili shihte këtu

27) Ky i fundit nuk na thotë se ku është mbështetur për pohimin e tij se forma e tipit *me ba* ka ekzistuar dikur edhe në toskërishte, por flet (f. 78) vetëm për «ekzistencën e një lloji tjetër mbeturinash të tipit *me bërë* në toskërishte (sidomos në të folmet arbëreshe)». Në f. 77 ai thotë se shqyrtimit të tipit *me ba* po i kushton një punim të veçantë.

28) Pedersen, megjithëse mendon se edhe toskërishtja e ka pasur paskajoren, e vë në dyshim ekzistencën e paskajores gege të tipit *me ba* edhe në toskërishte (art. i cit., 92); ai e kish fjalën për një paskajore pa *me*, formalisht identike me pjesoren.

29) Shih St. Ling. Alb. I, 144-145. Ai pohon se paskajorja në toskërishte është zhdukur para ardhjes së arbëreshëve në Itali.

30) Shih *Omagiu lui Jorgu Jordan*, f. 734.

31) Rohlfsi ka shfaqur mendimin se zëvendësimi i paskajores me lidhoren në bullgarishte nën ndikimin e greqishtes duhet të jetë vërtetuar jo më parë se shek. XI. Nëpërmjet bullgarishtes popullore dobësimi ose zhdukja e paskajores sipas tij, u përhap në rumanishtë në një periudhë, që është vështirë të përcaktohet, «por sigurisht në një periudhë dhe në një trevë, ku bashkëjetesa midis sllavëve dhe rumunëve kishte krijuar një simbiozë të ngushtë gjuhësore. Nga Maqedonia, ku humbja e paskajores është absolute, format e zëvendësimit do të kenë kaluar shpejt dhe pa kufizim tek barinjët rumunë (aromunë) të atyre viseve, për t'u përhapur në kohë më të reja, pak nga pak, në disa zona të Serbisë qendrore dhe veriore, por pa sjellë këtu një zhdukje tërësore të paskajores.»

32) Për ndikimin e greqishtes në zhdukjen e paskajores në gjuhët e Ballkanit janë shprehur më parë, përveç Sandfeldit, edhe G. Majeri e H. Pedersen (shih artikullin e cituar të këtij të fundit në IF 12 Anzeiger, f. 91).

një ndikim të ngjashëm me atë që greqishtja ka ushtruar, sipas tij, në bullgarishte e, nëpërmjet kësaj, edhe në rumanishte, aromunishte e serbishte, Gabinski orvatet të zbatojë, pa ndonjë mbështetje historike dhe gjuhësore, teorinë e tij të substratit. Ja si shkruan ai për këtë:

«Le të shënojmë se bilinguizmi ose madje greçiteti gjuhësor (грекоязычност) i hershëm i disa rajoneve të Toskërisë (shih Han, I, 14, 40: Селищев 79; Десница, мая, 33-34) dhe njësia e saj e sotme gjuhësore faktikisht tregojnë ekzistencën e substratit grek dhe, si rrjedhim, sipërinë, në kushtet e njohura, të gjuhës shqipe që e zëvendësoi atë. Veç kësaj, kufinj të e humbjes së paskajores në gjuhën shqipe nuk përkojnë pikë për pikë me zonat e përhapjes së leksikut prej origjine greke, i cili në toskërishten e përbashkët në thelb është po ai i gegërishtes së përbashkët. Në arbërishten le Italisë — Sh. D.] ku elementit grek në leksik është më i madh, paskajorja pjesërisht është ruajtur.» (f.48).

Edhe në këtë rast Gabinski operon me premisa të pavërtetuara, madje të gabuara ose të trilluara. Le t'i shqyrtojmë këto një nga një:

Së pari, Gabinski niset nga premisa e pavërtetuar se në disa rajone të Toskërisë dikur fliteshin të dy gjuhët (shqip dhe greqisht), ose madje vetëm greqisht. Autori nuk thotë gjë se për cilat rajone të Toskërisë e ka fjalën, por vetëm citon Hanin, Selishçevin dhe Desnickajan, dy nga të cilët (Hanin dhe Selishçevin) nuk i ka interpretuar saktë. Por, para se ta sqarojmë këtë pikë, e quajmë të nevojshme të bëjmë një saktësim. Toponimi Toskëri, që sot përdoret zakonisht për të emërtuar gjithë Shqipërinë Jugore, të paktën gjer në kohë të Hanit, përfshinte një trevë më të kufizuar. Në atë trevë, as në kohë të Hanit as më parë nuk kanë ekzistuar fshatra, ku të flitej greqisht e shqip e aq më pak vetëm greqisht.

Në veprën e Hanit (Albanesische Studien, I, 14, 40), të cituar nga Gabinski, flitet për përhapjen e gjuhës shqipe e të greqishtes në viset, që ndodhen në jug të kufinjvet të sotëm politikë të shtetit shqiptar gjer te bregu verior i gjirit të Ambracias (I, 14-15) si edhe në viset e skajit ekstrem të pjesës jugore të shtetit shqiptar (I/40-41). Në të dy rastet Hani përshkruan përhapjen e shqipes e të greqishtes në ato vise *në kohën e tij* pa folur fare për gjendjen gjuhësore të atyre trevave *në kohë më të vjetra*. Po të vështrohet kjo gjendje gjuhësore në zhvillimin e saj historik, nuk është shumë vështirë të nxirret përfundimi se është greqishtja ajo që ka përparuar gjatë shekujvet drejt veriut dhe jo anasjelltas. Në këtë përfundim mund të arrihet edhe nga sa thotë vetë Hani, i cili në I, 14 flet për fshatra shqiptare si ato të Sulit etj. (brenda kufinjve të sotëm politikë të shtetit grek), ku «gjuha e shtëpisë dhe e familjes» ishte shqipja dhe ku «edhe gratë e fëmijët» kuptonin greqisht, kurse në «disa ishuj gjuhësorë thjesht grekë» po të asaj treve «as burrat nuk kuptonin shqip». Edhe në I, 41, ku bën fjalë për krahinën e Gjirokastrës, Hani shënon se në krahasim me 50 shqiptarë «që flasin greqisht» [= që dinë greqisht — Sh. D.] «mezi gjëndet një grek që flet shqip». Dhe më poshtë ai shton se «greku e vështron gjuhën shqipe si një idiomë barbare me një përbuzje prej sovranit».

Pra, po të kihen parasysh këto të dhëna të Hanit, nuk mund të arrihet në asnjë mënyrë në përfundimin e gabuar të Gabinskit, sipas të cilit «bilinguizmi ose madje greçiteti gjuhësor i hershëm i disa rajoneve të Toskërisë dhe njësia e saj e sotme gjuhësore tregojnë faktikisht ekzistencën e substratit grek.»

Burimi i dytë, mbi të cilin Gabinski e ka mbështetur hipotezën e

tij mbi të ashtuquajturin «substrat grek» të Toskërisë janë supozimet, që bën Selishçevi në f. 79 të veprës së tij Славянское население в Албании, ku thuhet:

«Duhet supozuar se në mjedisin popullor në shekujt XIV-XV dhe më vonë ishin në përdorim sipas viseve dy gjuhë: në disa [vise] greqisht dhe shqip, në disa të tjera — shqip dhe sllavisht, në disa të tjera akoma — shqip dhe romanisht (aromunisht). Si rrjedhim i rrethanave të ndryshme të jetës shoqërore-nacionale në rrjedhën e kohës një gjuhë ia lëshonte vendin tjetrës duke dalë jashtë përdorimit gjatë një sërë brezash. Në veriperëndim, në Diokle (Zeta), gjuha shqipe doli jashtë përdorimit në një sërë visesh: [qël] kaluan në gjuhën serbe. Të njëjtin fat pësoi atje edhe gjuha romane.

«Në Epir dhe Shqipëri shumë romanë (aromunë-vllehë) u shqiptarizuan. Në Epir dhe Shqipëri doli jashtë përdorimit edhe gjuha sllave».

Siç shihet, Selishçevi bën vetëm *supozime* për gjendjen gjuhësore të Shqipërisë në shekujt XIV-XV dhe më vonë. Aty ai flet vetëm për përdorimin e dy gjuhëve — greqisht dhe shqip, shqip dhe sllavisht, shqip dhe aromunisht — sipas viseve; bën fjalë edhe për shqiptarizim aromunësh dhe për daljen jashtë përdorimit të gjuhës sllave, por nuk flet fare për ndonjë shqiptarizim «grekësh» ose për daljen e greqishtes jashtë përdorimit. Edhe sikur t'i prananim si të sakta këto supozime të Selishçevit, të cilat, sipas mendimit tonë, i duhen nënshtruar një kritike historike serioze, prapë nuk mund të nxirrej prej tyre në asnjë mënyrë përfundimi i Gabinskit mbi të ashtuquajturin «substrat grek» të Toskërisë.

Burimi i tretë, mbi të cilin Gabinski e mbështet hipotezën e tij, është artikulli i Desnickajas Из истории албанского языка³³, f. 33, ku flitet, ndër të tjera, për ndikimin e madh që ka ushtruar perandoria bizantine gjatë gjithë Mesjetës, duke nisur nga shekujt IV-V, mbi jetën politike, ekonomike dhe kulturele të fisevet shqiptare. Si vë në dukje se bashkë me latinishten greqishtja ishte gjuha zyrtare e administratës dhe e letërkëmbimit në Shqipërinë mesjetare, autorja shton: «Një rol të madh në përhapjen e gjuhës greke luajti gjithashtu edhe kisha ortodokse. Në gjuhën greke fliste një pjesë mjaft e madhe e popullsisë së qyteteve shqiptare të vendosura në brigjet e detit Jon. Veç kësaj, në Jug të Shqipërisë (Epir) fshatrat shqiptare e greke që prej kohësh të lashta kanë jetuar në fqinjësi të pandërprerë midis tyre, gjë që ka krijuar kushtet për një veprim [ndikim — Sh. D.] reciprok gjuhësor të vazhdueshëm.»

Edhe nga këto pohime të Desnickajas, e cila nuk na i jep burimet, prej nga i ka marrë të dhënat e mësipërme, nuk mund të nxirret në asnjë mënyrë përfundimi i Gabinskit mbi të ashtuquajturin «substrat grek» të Toskërisë. Dhe, në të vërtetë, nga fragmenti i cituar i Desnickajas, për të cilin ne kemi mjaft rezerva³⁴, del qartë se gjatë shekujvet të Mesjetës nuk është gjuha shqipe ajo që ka shtytur greqishten më nga jugu,

33) Botuar në Научные доклады высшей школы—Филологические науки, 1958/2.

34) Përsa i takon pohimit se «një pjesë mjaft e madhe e popullsisë së qyteteve shqiptare të vendosura në brigjet e detit Jon» fliste greqisht, nuk kuptohet se për cilat qytete e ka fjalën autorja — për qytetet shqiptare të bregdetit Jon, që bëjnë pjesë në shtetin shqiptar, apo për ato qytete me popullsi shqiptare që më 1912 mbetën jashtë kufinjvet politikë të Shqipërisë. Sidoqoftë, pohimet e Desnickajas mbetën vetëm pohime të paargumentuara historikisht.

por përkundrazi është greqishtja ajo që është shtrirë më nga veriu. Veç kësaj, Desnickaja bën fjalë vetëm për një ndikim reciprok gjuhësor midis shqipes dhe greqishtes gjatë shekujvet të Mesjetës dhe jo për ekzistencën e ndonjë substrati grek në Toskëri.

Për të vërtetuar hipotezën e tij mbi humbjen e paskajores në gjuhët ballkanike nën ndikimin e substratit dhe duke u mbështetur edhe në «njësinë e sotme gjuhësore» të Toskërisë, Gabinski, me sa del prej formulimit të tij, shkon aq larg sa ta shtrijë truallin e këtij të ashtuquajturit «substrat grek» në të gjithë Toskërinë³⁵ (sic!).

Gabinski nuk jep ndonjë sqarim as për «kushtet e njohura», në të cilat gjuha shqipe paska fituar sipërinë mbi gjuhën greke, gjersa e paska nxjerrë jashtë përdorimit në Toskëri (sic!). Kurse në f. 154 të veprës së tij ai pohon se *ndikimi i greqishtes mbi toskërishten* «nëpërmjet shkollës dhe kishës ortodokse dhe nëpërmjet bilinguizmit të përditshëm në disa rajone» ka vazhduar gjer aty nga fillimi i shek. XX.

Edhe mendimi i tij që leksiku prej origjine greke «në toskërishten e përbashkët në thelb është po ai i gegërishtes» (f. 48), nuk i përgjigjet së vërtetës.

Përsa i takon mendimit që paskajorja e tipit *me ba* është ruajtur pjesërisht në arbërishten e Italisë, ndonëse atje «elementi grek në leksik është më i madh», do të vërejmë:

1) Në veprën e më të vjetrit shkrimtar arbëresh të njohur gjer më sot, L. Matrëngës (1592), nga Hora e Arbëreshëve në Sicili, nuk gjëndet asnjë gjurmë e kësaj paskajoreje. Asnjë gjurmë e tillë nuk haset as në veprën e Jul Varibobës (1762) nga katundi Mbuzat i Kalabrisë, as edhe në shkrimet e tjera arbëreshe të shek. XVIII me përjashtim të veprës «I krishteu i arbresh» të N. Filjes nga katundi Munxifs (Mezzoiuso) në Sicili³⁶. Gjurmë të kësaj paskajoreje hasen aty-këtu edhe në shkrimet e Santorit³⁷, të de Radës³⁸ e të Darës³⁹ si edhe tek Zef Skiroi, i cili paskajoren e tipit *me ba* e ka marrë me siguri në mënyrë të vetëdijshme nga gegërishtja. Edhe në shkrimet e Santorit e të De Radës (sidomos në shkrimet e fundit të këtij) nuk përjashtohet mundësia e ndikimit geg.

35) Këtu do shënuar se, kur flet për zhdukjen e paskajores në disa nëndialekte të Italisë Jugore, autori pohon se zhdukja e paskajores është vërtetuar në ato vise, popullsia e të cilavet dikur fliste greqisht; kurse «në krahinat e tjera të Italisë (duke përfshirë edhe krahina jugore, ku leksiku grek përfaqësohet në mënyrë të pasur), që kanë qenë gjithashtu për një kohë të gjatë nën Bizantin, por që nuk kanë pasur një popullsi greke kompakte, nuk ka humbje paskajoreje». (f. 50).

Ky mendim nuk pajtohet me atë që ka shprehur autori për zhdukjen e paskajores në gjithë toskërishten.

36) P.sh.: ...*andej kã mo ardhurë mo gjkuarë të gjalltë e të vudekurit...*; ... *çë do me thënë liruas...* Thuajm, trimarak, cilat shërbise janë *për me o bërë* sa t duam... Shih *Il cristiano albanese* (I krishteu i arbresh), botuar nga M. Marchianò më 1911, f. 19, 16, 21.

37) P.sh.: E janë motëra *për me këntuar* këta? Banitët lëtinj kanë udhë *me i dërguar* krëhëra e anakë të arta zonjavet...; etj. (nga drama *Emira*, ribotuar nga Z. Kodra më 1959; f. 42, 44 etj.).

38) Ngjitej vet po *me i thën* — se ajo e doj zōnja e jëma (Milosao, bot. II, 1847, K. IV, f. 18. Ashtu diål kë sgjuan ndënat. *-me vatur* ndë detit... etj. (*Uno specchio di umano transito*, f. 9 etj.)

39) Në dy prozat (parathënie dhe pasthënie) të veprës së tij *Kënka e sprasme e Balës*, Dara (i riu) ka përdorur 2 herë shprehjen e ngurosor *vien-me-thën* dhe 1 herë shprehjen tjetër të ngurosor *vien-me-rar*, që të dyja në kuptimin *do-methënë*. *Vien-me-rarë*, sipas La Pianës (St. Ling. Alb. I, 143), përdoret në të folmet arbëreshe të Sicilisë.

Më problemor paraqitet përdorimi i paskajores tek Filja dhe G. Dara (i Riu).

2) Edhe po të pranojmë ruajtjen e pjesshme të paskajores së tipit *me ba* tek arbëreshët e Italisë, kjo nuk provon atë që kërkon të vërtetojë Gabinski, se në Toskëri paskajorja është zhdukur nën ndikimin e «substratit grek». Pjesa më e madhe e arbëreshëve të Italisë e kanë origjinën nga shqiptarë të shpërngulur prej Shqipërisë Jugore si edhe nga katundet arbëreshe të Moresë (Greqi), treva këto, ku paskajorja e tipit *me ba*, në rast se ka ekzistuar, duhet të jetë zhdukur që heret, d.m.th. para shpërnguljeve të arbëreshëve për në Itali (shek. XVI-XVIII).

3) Përsa i takon depërtimit më të madh të elementit grek në leksikon e të folmevet arbëreshe të Italisë, do pasur parasysh se, sikurse e ka shpjeguar E. Çabej⁴⁰, një dukuri e tillë e ka burimin tek fakti që arbëreshët e Italisë grecizmvat, që kanë marrë me vete nga Shqipëria, u kanë shtuar edhe të tjera, që kanë hyrë në të folmet e tyre nëpërmjet arbëreshëve të ardhur nga Greqia si edhe nëpërmjet kontakteve me katundet greke (e pjesërisht edhe me katundet italiane) të Italisë Jugore.

Pra, në dritë të këtyre fakteve, mendimi i Gabinskit mbi të ashtuquajturin «substrat grek», që paska qenë burimi i zhdukjes së paskajores në toskërishte, del pa asnjë mbështetje historike dhe gjuhësore dhe mund të konsiderohet si një trillesë e autorit për të mbështetur hipotezën e tij mbi zhdukjen e paskajores në gjuhët ballkanike nën ndikimin e substratit trak, hipotezë kjo që mbetet gjithashtu e paargumentuar. Siç u vu në dukje edhe më sipër, duke qenë trakishtja një gjuhë e panjohur për ne, është e pamundur të përcaktosh nëse ajo ka pasur apo s'ka pasur paskajore.

Edhe teza e mbrojtur nga Sandfeldi, Rohlfsi etj. mbi origjinën greke të kësaj dukurie në gjuhët ballkanike, siç e vumë në dukje më sipër, na duket e pambrojtshme. E në këto rrethana çështja e zhdukjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit mbetet një ndër çështjet e pazgjdhura të së ashtuquajturës «gjuhësi ballkanike». Ndoshta do të ishte më e arësyeshme të kthehemi tek hipoteza e poligjenezës së shfaqjes së kësaj dukurie në gjuhët e Ballkanit, ashtu siç kanë menduar një varg gjuhëtarësh në të kaluarën.

II

RRETH KRITEREVET TË DALLIMIT TË PASKAJORES SË DYTË NË GJUHËN SHQIPE

Është një fakt tashmë i njohur se gjuha shqipe gjatë zhvillimit të saj historik ka verbalizuar togjet e formuara nga emrat prejfoljorë asnjënjës të paraprirë nga parafjalët *për* dhe *me* si edhe nga numërori *një*⁴¹. Togu i tipit *për të bërë* përdoret në funksione, që përfshihen në sferën e përdorimeve të paskajores. Kohët e fundit. M. A. Gabinski ka shprehur mendimin se edhe forma e rrjedhores së emrave prejfoljorë asnjënjës

40) Hyrje në historinë e gjuhës shqipe dhe Fonetika historike e shqipes (dispensë — 1960), f. 46.

41) Shih, ndër të tjerë, Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, f. 122 v.

në konstruktet e tipit *mbarova së foluri* dhe *u lodha së foluri* është verbalizuar gjithashtu si një «paskajore in statu nascendi».

Natyrisht, para se të pohohet vlera infinitivale e një togu (apo e një forme emërore) të dhënë, duhet vërtetuar që ai (apo ajo) është verbalizuar, d.m.th. ka kaluar në klasën e foljevet. Por një punë e tillë në përgjithësi nuk është bërë lidhur me togjet e verbalizuara të shqipes. Shumica e atyre që kanë pranuar vlerën infinitivale të togut të tipit *për të bërë*, janë mbështetur në sinoniminë funksionale të pjesëshme, që ai ka me paskajoren e tipit *me ba*, ose me paskajoret e gjuhëvet të tjera indoevropiane. Por sinonimia funksionale nuk mund të shërbejë në asnjë mënyrë si kriter i vetëm për të vërtetuar kalimin e një togu parafjalor apo të një forme emërore të dhënë në kategorinë e paskajores.

Duke u marrë me vlerën e togut të tipit *për të bërë* në kumtesën e mbajtur në Konferencën e parë të studimeve albanologjike të vitit 1962⁴², ne jemi përpjekur të provojmë karakterin foljor të togut të tipit *për të bërë* dhe përdorimin e tij si një paskajore me funksione sintaksore të kufizuara. Pikëpamjet e shprehura në atë kumtesë i kemi shtjelluar më tej në një punim tjetër ende të pabotuar, ku kemi shqyrtuar edhe vlerën e togjeve të tipit *me të ardhur* dhe *një të ardhur*.

Duke qenë se edhe Gabinski në kapitullin e parë të veprës së tij i ka kushtuar një vëmendje të posaçme kriterit të dallimit të paskajores së dytë në gjuhën shqipe, mendojmë që të ndalemi këtu në shqyrtimin e pikëpamjevet të tij. Në një vepër si ajo e Gabinskit, që merret kryesisht me shqyrtimin e çështjes së paskajores së dytë në gjuhën shqipe, parashtrimi i kriterëve për dallimin e paskajores nga emri ishte i domosdoshëm për të përcaktuar mirë kufirin, që ndan të parën nga i dyti. Nga ana tjetër, vetë paskajorja do të dilte e papërcaktuar, po të mos sqarohet më parë çështja e klasës më të gjërë, ku ajo bën pjesë si një formë e pashtjellë, d.m.th. po të mos përcaktohet kategoria leksiko-gramatikore e foljes.

Sipas Gabinskit, emri «është një klasë fjalësh (një pjesë e ligjëratës), që përfshin emërtime sendesh nomenclonale dhe që përfaqëson gjithçka tjetër, të shënjuar në po atë kompleks kategorish gramatikore» (f. 17-18). Ai vë në dukje se emri në gjuhën shqipe «shpreh gjininë, numrin dhe rasën, por, ndryshe nga rusishtja, shpreh edhe shquarësi — pashquarësi dhe nuk shpreh frymorësi-jofrymorësi.» (f. 13). Por në f. 16 ai vëren se në gjuhë të ndryshme disa tipa emrash veprimi «karakterizohen nga veti të tilla të përbashkëta me foljen si dallimi i aspektit, i diatezës, i kohës relative si edhe shoqërimi me ndajfolje, transitiviteti ose përdorimi absolut.» Ai shton se edhe emrat e tipit *të bërë* në gjuhën shqipe kanë disa nga këto veti, që ai i shtjellon në f. 71-73, ku flet për «vetitë foljore të emraveve prejparticiporë të veprimit dhe raportin e këtyre vetive me substantivitetin.» Këtu ai shënon, ndër të tjera, se emrat e tipit *të bërë* mund të shoqërohen me ndajfolje (p.sh... të përdorurit dendur e me vend të prapashtrësave...), mund të marrin përcaktorë (p.sh. ...po vështirësohej të qëndruarit asnjans...), (f. 71), mund të marrin edhe kundrina të drejta në rasën kallëzore (p.sh. të zanëtë fill) (f. 72). Si shënon se emrat e veprimit në gjuhën shqipe «praktikisht nuk e dallojnë kohën relative», autori shton: «Megjithatë, në raste të veçanta janë të mundshme ndërtime të tipit të arbërishtes së Siçilisë. — Gjë nuk ka më t'mirë se t'pasunit klënë mbi

42) Botuar në vëllimin «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë, 1965, f. 213-220.

dheun...» (Skiro, CT, 509) (f. 72). Së fundi ai shënon (f. 72-73) se në gjuhën shqipe, ndryshe nga ç'ndodh në polonishte, çekishte, maqedonishte etj. emri nuk i dallon diatezat.

Kurse paskajorja, sipas tij, është «çdo formë foljore josintaksore, që është e aftë për një përdorim të pavarur». (f. 29). Formë foljore josintaksore, sipas tij, është ajo formë që nuk dallon kategoritë sintaksore (f. 27). Me përdorim të pavarur ai kupton përdorimin në funksionin e kryefjalës e të pjesës emërore të kallëzuesit si edhe në funksionin quajtës (f. 28). Ai shënon (f. 31) se «aftësia për përdorim të pavarur si tipar i paskajores s'duhet marrë si eksklusivitet i këtij përdorimi» dhe pak më poshtë shton se në shumicën e gjuhëve paskajorja përdoret më fort në pozicione të varura.

Sipas Gabinskit, dallimi i diatezës, i aspektit, i kohës relative, si edhe shoqërimi me ndajfolje, transitiviteti dhe përdorimi absolut, «që merren dëndur si tipare të foljes, duke përfshirë paskajoren», «në të vërtetë nuk janë të tilla» (f. 30). Këtë qëndrim ai e arësyeu me atë që ka vënë në dukje në f. 16 si edhe në f. 71-73, se këto veçori në gjuhë të ndryshme i kanë edhe disa tipa emrash foljorë. Si tipar i foljes, sipas tij, konsiderohet «të mospasurit lidhje me kategoritë që janë të panjohura për format thjesht predikative joemërore të gjuhës së dhënë, ashtu si edhe reksioni i tyre karakteristik (konsiderohet) si shprehës i objektit të veprimit⁴³. Për sa i takon gjuhës shqipe, është fjala për të mospasurit lidhje me kompleksin e kategorivet të emrit si edhe për reksionin e kallëzores» (f. 80).

Për metodën, që ka ndjekur për të përcaktuar ekzistencën e formës së paskajores së dytë në gjuhën shqipe, ai na flet që në Hyrje, ku shkruan, ndër të tjera: «Duke qenë se në këto kushte zbatimi i kriterevet materiale, që zakonisht i identifikojnë lehtë paskajoret e vjetra të gjuhëve të njohura mirë, nuk jep rezultate, këtu propozohet një metodë tjetër për individualizimin formal të faktevet në shqyrtim, dhe pikërisht metoda e analizës sipas ruajtjes — humbjes së sintaksësisë së formavet rasore ose të togjevet parafjalore të emrit para-infinitival të veprimit.» (f. 3). Më tutje (f. 80), duke bërë fjalë për kushtet e shfaqjes së një forme foljore prej një emri, ai thotë se këto janë «desubstantivimi kategorial» i emrit dhe marrja «e drejtimit foljor». Me «drejtim foljor» në këtë rast ai kupton këtë që një formë foljore (e sajuar prej një emri foljor) e ka të detyrueshëm (dhe jo më fakultativ) shoqërimin me ndajfolje dhe me kundrina të drejta.

Me anë të kësaj metode, siç do ta shtjellojmë edhe më tutje, Gabinski arrin në përfundimin se forma e tipit *së bëri* në togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* në shqipe e sotme është shndërruar në një formë foljore të pashpjellë, që kualitativisht është shumë afër paskajores (f. 80 etj.). Po me anë të kësaj metode ai ka arritur në përfundimin se togu i tipit *për të bërë* vetëm sporadikisht ka marrë vlerën e një paskajoreje të dytë (f. 202).

Lidhur me çështjen e lindjes së paskajores së dytë në gjuhën shqipe (dhe në rumanishte) të tërheq vëmendjen edhe një hipotezë tjetër e autorit, i cili shkruan (f. 74) se «kjo humbje [e paskajores nën ndikimin e substratit — Sh. D.], nga ana e saj, është e lidhur... me shfaqjen e infinitivitetit të ri në gjuhët e sotme ballkanike, duke qenë një nga premisat e tij më të rëndësishme. Megjithatë, lidhja midis ndikimit të mundshëm të substratit mbi gjuhët e Ballkanit dhe lindjes së paskajoreve të dyta në to

43) Ja si e përkufizon foljen ai (f. 26): «Folja është një klasë fjalësh (një pjesë e ligjëratës), që nuk dallojnë asnjë nga kategoritë e panjohura për predikatorët joemërorë dhe që drejtojnë në mënyrë të njëjtë me ta.»

(ose në gjuhët vazhduese të tyre) në asnjë rast nuk është e drejtpërdrejtë. Është fjala, as më shumë e as më pak, për marrëdhënje krejt të ndërmjeme (mediate), të lidhura me ligjin e mohimit të mohimit».

* * *

Siç shihet edhe nga kjo paraqitje e përmbledhur, për të argumentuar pikëpamjet e tij mbi çështjen e paskajores së dytë në gjuhën shqipe. Gabinski është përpjekur t'i mbështetë ato me një varg premisash teorike, që, siç do ta shtjellojmë këtu më poshtë, bashkëbartin një varg të metash dhe kundërthënesh. Ai në disa raste nuk është treguar as konsekuent në zbatimin e kriterëve të njëjta në trajtimin e çështjeve të ngjashme. Le të marrim, p.sh., përkufizimin e emrit dhe të foljes. Ndërsa në përkufizimin e emrit ai mbështetet në kriterin leksikor dhe në atë gramatikor, në përkufizimin e foljes mbështetet vetëm në kriterin gramatikor.

Në trajtimin e këtyre dy kategorive leksiko-gramatikore vihet re edhe një tjetër inkonsekuencë. Ndërsa në përcaktimin e tipareve gramatikore të emrit në gjuhën shqipe ai mbështetet në vetë të dhënat e kësaj gjuhe, në përcaktimin e tipareve gramatikore të foljes ka vepruar ndryshe. Për emrin ai thotë shkoqur se në gjuhën shqipe kjo klasë fjalësh përveç kategorive gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës (që i ka edhe gjuha ruse) ka edhe atë «të shquarësisë — pashquarësisë» (f. 13). Kurse, nga ana tjetër, nuk pranon si tipare të foljes as kategori të tilla gramatikore si diatezën dhe kohën relative⁴⁴ (f. 30). Për të përligjur këtë qëndrim, autori na thotë se në disa gjuhë të tjera edhe emrat e veprimit e dalluakan kohën relative (si italishtja, hispanishtja dhe portugalishtja) ose diatezën (si polonishtja, çekishtja, maqedonishtja etj.) (f. 72). Për gjuhën shqipe ai pohon se «në raste të veçanta janë të mundshme ndërtime të tipit të arbërishtes së Siçilisë — Gjë nuk ka më t'mirë se *t'pasunit klënë* mbi dheun...» (Skiro, CT, 509), d.m.th. pranon dallimin e kohës relative edhe tek emrat prejparticiporë të tipit të bërë «në raste të veçanta». Kurse për dallimin e diatezave tek emrat prejfoljorë në gjuhën shqipe ai thotë se «ashtu si në shumë gjuhë të tjera, kjo bëhet e ditur vetëm në formimet e leksikalizuara, që ndërthejnë elementin *vetë* - (krahaso sllav. *camo* -, gr. *αὐτο* - që është bërë ndërkombëtare, angl. *self* -, gjerm. *Selbst* -, *Sich* -, etj.)».

Lidhur me këto, në radhë të parë do pasur parasysh se *t'pasunit klënë* nuk haset në të folmet e katundeve arbëreshe të Siçilisë (apo të Kalabrisë), as në veprat e shkrimtarëve arbëreshë të atyre katundeve; këtë fjalë e ka përdorur një herë të vetme Zef Skiroi në poemën «Mino» (shih Canti Tradizionali, 509). Këtu kemi të bëjmë me një kalkim të izoluar nga italishtja, që nuk përligjet nga pozitat e shqipes, sepse në këtë gjuhë nuk ekziston (as nuk ka ekzistuar) ndonjë formë foljore perifrastike e tipit *pasunë klenë* a *pasë qenë*⁴⁵. Gjithashtu nuk mund të flitet për dallim diatezash në gjuhën shqipe (as në gjuhët e tjera të

44) Të njëjtin qëndrim mban ai edhe për kategorinë e aspektit.

45) Megjithatë, në disa gramatika kjo formë perifrastike e paqenë është paraqitur si pjesore e kryer a e shkuar, si p.sh. në gramatikën e Kristoforidhit, (shih f. 114, 123 etj.), të I. Dilo Sheperit (shih f. 71, 81 etj.), të O. Myderrizit (shih f. 128 etj.), të K. Cipos (shih f. 131 etj.) etj.

Edhe Sami Frashëri e ka trajtuar formën perifrastike të paqenë të tipit (të) *pasurë qënë*, (të) *pasurë pasurë* etj. (f. 70, 65 etj.) me vlerën e paskajores së kryer.

përmendura nga autori: sllavishtja, greqishtja, anglishtja, gjermanishtja) në fjalë të përbëra, që kanë si gjymtyrë të parë fjalën *vetë* -.

Nga ana tjetër, edhe sikur të pranohet ekzistencën e këtyre dy kategorive gramatikore tek emrat e veprimit në disa gjuhë indoevropiane (gjë që, sipas mendimit tonë, nuk është e saktë), kjo nuk do të thoshte që koha relative dhe diateza nuk janë tipare foljore edhe në vetë ato gjuhë e jo më në një gjuhë të tillë si shqipja, e cila këto dy kategori i ka vetëm tek foljet. Po ta zbatonte në mënyrë konsekuente këtë kriter Gabinski, atëherë ai aq më pak duhej t'i njihje emrit në gjuhën ruse kategorinë e gjinisë, meqë këtë kategori në atë gjuhë⁴⁶ e kanë edhe disa forma foljore (p.sh. *был, была, было*, që të mos përmendim këtu format e ndryshme të pjesores së tashme e të shkuar në të dy diatezat). Për më tepër, në jemi të mendimit se edhe në gjuhët, që përmend Gabinski, nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e kategorivet gramatikore të kohës relative e të diatezës tek emrat e veprimit me origjinë paskajoreje në kuptimin që emrat infinitivalë «të kohës relative», përkatësisht «të diatezës joveprore» të jenë sajuar nga «format» përgjegjëse të emrave infinitivalë «të kohës së tashme», përkatësisht «të diatezës veprore». Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me substantivime paralele të paskajores së kohës së tashme dhe të kohës së kryer, përkatësisht të diatezave veprore dhe joveprore⁴⁷.

Për të gjitha këto arësye ne mendojmë se kategoria e kohës së kryer si edhe ajo e diatezës në gjuhën shqipe (dhe jo vetëm në gjuhën shqipe) janë tipare karakteristike të foljes. Si rrjedhim, shfaqja sistematike e njërës prej tyre (ose e të dyjave) në një tip formimi do konsideruar si një nga shenjat e verbalizimit të tij.

Kemi edhe ndonjë vërejtje për metodën e përdorur nga Gabinski (f.3) për të vërtetuar shfaqjen e paskajores së dytë në gjuhët shqipe dhe rumanishte. Metoda e analizës sipas ruajtjes, përkatësisht humbjes «së sintaksësisë së formave rasore ose të togjevet parafjalore të emrit para-infinitival të veprimit» në këtë rast të jep vetëm ruajtjen, përkatësisht humbjen e karakterit emëror të emrit prejfoljor në shqyrtim, por jo edhe lindjen e paskajores së dytë. Këtë pamjaftësi e ka ndjerrë edhe vetë Gabinski, i cili në f. 80 e gjetkë e plotëson këtë metodë duke shtuar edhe marrjen e «drejtimit foljor» e me këtë ai kupton shoqërimin me ndajfolje dhe me kundrina të drejta në rasën kallëzore. Por edhe ky plotësim është i pamjaftueshëm, sepse ai mund të shërbejë vetëm për të vërtetuar karakterin foljor të një forme të dhënë, por jo shfaqjen e paskajores së dytë. Prandaj, në f. 29 e gjetkë ai shton edhe një kusht tjetër për shfaqjen e paskajores së dytë — është fjala për përdorimin e formës foljore të dhënë në funksione të pavarura.

Këtu do shënuar se Gabinski, megjithëqë shoqërimin me ndajfolje dhe transitivitetin nuk i quan tipare të foljes, meqë këto i kanë edhe disa emra veprimi (shih më sipër), ai edhe në këtë rast nuk mban një qëndrim konsekuent. Kur kërkon të vërtetojë që forma e tipit *së bëri* ka marrë tipare foljore, vë në dukje pikërisht këto dy tipare, duke shënuar se tek emrat prejparticiporë të veprimit ato janë fakultative, kurse tek forma, sipas tij, e verbalizuar *së bëri* ato janë shndërruar «në

46) Të kihen parasysh edhe gjuhët neolatine, si edhe greqishtja, në të cilat pjesorja e shkuar merr forma të ndryshme sipas gjinisë dhe numrit, edhe kur përdoret si pjesë përbërëse e formave të kohëve të përfektit (në gjuhët neolatine).

47) I njëjti shpjegim, sipas mendimit tonë, do dhënë edhe për dallimin e pretenduar të aspektit tek emrat.

një normë të domosdoshme» (f. 82, shën. 3). Një qëndrim të ndryshëm mban ai, kur flet për praninë e këtyre tipareve tek togu i tipit *për të bërë*, të cilit, siç do ta shtjellojmë më tutje, në disa funksione, duke përfshirë funksionin kryesor, i mohan edhe karakterin foljor (f. 163-4).

Ne mendojmë se shoqërimi me ndajfolje dhe kundrina të drejta, që janë dukuri të karakterit sintaksor, mund të shfrytëzohen (dhe duhen shfrytëzuar) si argumenta plotësues, por jo si të vetmit argumenta, ashtu siç bën Gabinski, për të vërtetuar verbalizimin e një forme të caktuar emërore. Gjithashtu mendojmë se marrja e kundrinës duhet të konsiderohet si tipar foljor në gjuhën shqipe vetëm në ato raste kur kundrina e drejtë (ashtu si edhe e zhdrejta) mund të shprehen edhe me anë të trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, të cilat, siç dihet, në shqipe përdoren vetëm me forma foljore.

Pra, për kalimin e një forme emërore ose të një togu parafjalor (parafjalë + emër) në sistemin foljor të shqipes, sipas mendimit tonë, duhen plotësuar këto dy kushte: 1) desubstantivimi i formës emërore ose i togut parafjalor; 2) marrja e tipareve foljore: a) kategori gramatikore të foljes (diatezë etj.); b) drejtimi foljor (marrja e kundrinave të drejta e të zhdrejta edhe në formën e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, marrja e një kryefjale të veçantë si edhe shoqërimi me ndajfolje e jo me mbiemra); c) të përdorurit me pjesëza mohimi që janë karakteristike për format foljore.

Përsa i takon kriterit të përcaktimit të paskajores së dytë në gjuhën shqipe (dhe rumanishte), në vija të përgjithshme ne pajtohemi me Gabinskin, i cili e përkufizon paskajoren si «çdo formë foljore josintaksore, që është e aftë për një përdorim të pavarur» (f. 29), përkufizim ky që ai e plotëson dhe e saktëson me vërejtjen (f. 31) se në shumicën e gjuhëve⁴⁸ paskajorja përdoret më fort në pozicione të varura. Por, siç do ta shtjellojmë edhe më tutje, ne nuk pajtohemi me Gabinskin, përsa i takon mënyrës së zbatimit të kriterit të tij. Këtu po kufizohemi vetëm të theksojmë se, sipas mendimit tonë, përdorimi i një forme të pashtjellë foljore në tri funksionet e pavarura, që përmend ai (f. 28), nuk shënon fillimin por kushtin vendimtar për kalimin e saj të plotë në kategorinë e paskajores. Si rrjedhim, kur një formë e pashtjellë foljore përdoret vetëm në funksione të varura, edhe sikur këto të përfshihen në sferën e funksioneve të paskajores, ajo s'duhet quajtur paskajore. Por, kur ajo fillon të përdoret edhe në një a dy funksione (por jo në të gjitha funksionet) të pavarura, karakteristike për paskajoren, atëhere ne kemi plotësisht të drejtë ta quajmë atë paskajore me funksione sintaksore të kufizuara, aq më tepër kur duket qartë se forma foljore në shqyrtim me kalimin e kohës do ta fitojë aftësinë për t'u përdorur në të gjitha funksionet (të pavarura dhe të varura) të paskajores.

* * *

Përsa i takon lidhjes së ndërmjeme, që Gabinski kërkon të vendosë midis humbjes së paskajores nën ndikimin e substratit dhe lindjes së paskajores së dytë në disa gjuhë ballkanike (si shqipja dhe rumanishtja) si pasojë e veprimit të ligjit të mohimit të mohimit, do të vërejmë:

1) Ai në veprën e vet ka pohuar se protoshqipja s'duhet të ketë pa-

48) Ai nuk sqaron se në cilat gjuhë paskajorja nuk «përdoret më fort në pozicione të varura».

sur paskajore. Madje, siç e kemi vënë në dukje edhe më sipër, ai i ka kritikuar ata që kanë pohuar se shqipja e lashtë duhet të ketë pasur një paskajore të vjetër të krahasueshme për nga tipi strukturor me paskajoret e simotravet të saj indoevropiane. Prandaj, për gjuhën shqipe ai as që duhej të mendonte për një lidhje të ndërmjeme midis zhdukjes së paskajores së vjetër nën ndikimin e substratit dhe lindjes së paskajores së re.

2) Edhe po të jetë se në këtë rast Gabinski nuk ka pasur parasysh mbarë shqipen, por vetëm toskërishten, prapë mendimi i tij nuk qëndron. Edhe sikur të pranojmë që toskërishtja e ka pasur paskajoren e tipit *me ba*, të cilën e paska humbur nën ndikimin e «substratit grek», siç pretendon ai, fakti që paskajorja e dytë⁴⁹ nuk është shfaqur vetëm në toskërishte, por edhe në gegërishte, (ku është ende mjaft e gjallë paskajorja e tipit *me ba*), e bën të pambrojtshëm hipotezën e tij.

III

RRETH VLERËS SË TOGUT TË TIPIT PËR TË BËRË

Siç e kemi vënë në dukje edhe më parë⁵⁰, vlera foljore e togut të tipit *për të bërë* nuk është njohur nga të gjithë ata që janë marrë me studimin e gjuhës shqipe. Edhe M.A. Gabinski, i cili shqyrtimit të këtij togu i ka kushtuar gjithë kapitullin e tretë (f. 161-246) të veprës së tij, vlerën foljore (si paskajore) të këtij togu e ka pranuar vetëm për disa funksione. Duke qenë se ne nuk pajtohemi me një pjesë të mirë të mendimevet të tij, e pamë të arsyeshme të themi nja dy fjalë rreth tyre, duke sqaruar kështu edhe qëndrimin tonë lidhur me togun në shqyrtim.

Gabinski vë në dukje me të drejtë se togu i tipit *për të bërë* përdoret më dëndur në funksionin destinativ (qëllimor). Ai gjithashtu përmend se ky tog përdoret edhe në ndërtime tautologjike të tipit *për të ngrënë, hante...*, si edhe si pjesë përbërëse e së ardhmes së tipit *kam për të ardhur*. Ai nuk pajtohet me qëndrimin e atyre gramatikanëve dhe studjuesve të shqipes, të cilët kanë parë tek togu i tipit *për të bërë* në këto funksione një formë foljore me vlerën e paskajores, duke u mbështetur *implicite* në sinoniminë me paskajoren e tipit *me ba* (162, 169-183). Ai e kritikon me të drejtë të mbështeturit në sinoniminë funksionale si një kriter për të përcaktuar përkatësinë leksiko-gramatikore të një forme a të një togu të dhënë (f. 162, 175, 185).

Përveç funksionevet të lartpërmendura, për togun e tipit *për të bërë* Gabinski vë në dukje edhe funksionin kryefjalor (f. 206-7, 215 v., 220 v.), atributiv (219), kallëzuesor (f. 219), disa përdorime eliptike (f. 223-225), si edhe përdorimin në disa funksione të varura (f. 229 v.)⁵¹.

Ai i vë vetes si detyrë të përcaktojë kriteret e desintaksizimit të

49) Ne kemi parasysh vetëm togun e verbalizuar të tipit *për të bërë* (me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara) dhe jo formën e tipit *së bëri*, e cila, siç do ta shtjellojmë më tutje, nuk është verbalizuar.

50) Shih kumtesën tonë në «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», f. 213 v.

51) Me sa duket, në literaturën e vjetër autori nuk ka ndeshur ndonjë rast përdorimi të këtij togu të paraprirë nga paskajorja *me pasë*, në fjali të varura kushtore. P.sh. *Baba, me pasë për të na martue, më parë më marton mue, qi jam më e madhja*. (D. Kurti — Prralla, I, 108). Përdorime të këtij tipi hasen vetëm në disa të folme të Shqipërisë Veriore.

togut parafjalor të tipit *për të bërë* si edhe të përdorimit të tij si formë e pashtjellë foljore apo si paskajore e dytë *in statu nascendi*.

Lidhur me desintaksizimin e togut në shqyrtim mendimi i tij është ky:

«Ashtu si në sintetizëm emri në ligjërim nuk mund të përdoret jashtë një forme rasore konkrete, në analitizëm ai nuk ekziston jashtë formave të tij të emërores dhe një sërë togjesh parafjalore. Ashtu si forma rasore në sintetizëm, edhe togu parafjalor në analitizëm krijohet për të shprehur lidhjet e emrit me fjalë të tjera dhe ai [togu parafjalor] ekziston përdërisa shprehen këto lidhje, — me fjalë të tjera togu parafjalor është një fakt rreptësisht sintaksor.

«Si rrjedhim, kur togu parafjalor humbet sintaksësinë (duke rënë në pozita, ku nuk shprehen lidhjet e dhëna midis fjalëve), kjo tregon humbjen e vetë togut parafjalor dhe shndërrimin e kompleksit fonematik, prej të cilit përbëhet, në një fakt kualitativisht të ri. E duke qenë se emri në analitizëm nuk mund të përdoret në ligjërim (po të bëhet abstraksion nga format e emërores) jashtë një togu parafjalor konkret, humbja e këtij të fundit dëshmon në mënyrë të domosdoshme edhe humbjen e vetë emrit, sado gjatë që të ruhet pamja e jashtme e togut parafjalor... Ashtu si në sintetizëm edhe këtu desubstantivimi realizohet me anë të desintaksizimit» (f. 186; shih edhe f. 169, 201).

Nga sa del prej këtyre sqarimeve, Gabinski mendon se togu i tipit *për të bërë* desintaksizohet vetëm atëhere kur përdoret në funksione sintaksore, që nuk shprehen me anë të një emri të paraprirë nga parafjala *për* (f. 202 etj.), si p.sh. kur togu në fjalë përdoret në funksion kryefjalor, kundrinor dhe në ndonjë funksion tjetër, që do të vihet në dukje më poshtë.

Edhe për të përcaktuar nëse togu i tipit *për të bërë* ka vlerën e një paskajoreje të dytë apo jo, ai zbaton pothuaj të njëjtin kriter, d.m.th. mbështetet në humbjen, përkatësisht ruajtjen e sintaksisë së togut në fjalë (f. 186, 202 v.).

Përdorimi me një emër në rasën kallëzore (në vend të gjindores), shoqërimi me ndajfolje (në vend të mbiemrit), dallimi i diatezavet dhe i kohës relative⁵², si edhe përdorimi i emrit prejfoljor asnjëherë rregullisht në trajtë të pashquar, sipas tij, nuk tregojnë desintaksizimin e togut të tipit *për të bërë* (f. 163-164).

Edhe pamundësia e përdorimit të nyjes shquese në togun e tipit *për të bërë* (që e merr objektin në rasën kallëzore) nuk përbën, sipas Gabinskit, një shenjë desintaksizimi, sepse «opozicioni sipas shquarësisë — pashquarësisë tek emrat e shqipes në një sërë pozicionesh neutralizohet» (f. 164-165). Këtu ai përmend veçanërisht rastet kur emrat e veprimt përdoren pas parafjalësh (p.sh. *për botim, për kositje, për punë, për këngë* etj.). Megjithatë, ai shënon se, po të sqarohet çështja e caqevet të këtij neutralizimi të opozicionit në fjalë, nuk përjashtohet mundësia që *të bërë* në *për të bërë* të jetë desubstantivuar dhe si rrjedhim *për të bërë* të bëjë pjesë në format e pashtjella të foljes (f. 165).

Ai mendon se në dritë të këtyre fakteve «tipi *për të bërë* është një formim, që demonstroi me siguri vetëm shenja të përbashkëta pjesësh të ndryshme të ligjëratës — të emrit dhe të foljes ose, më konkretisht, të

52) Shih shën. 56.

emrit të veprimit (në togun e tij parafjalor) dhe të një forme të pashtjellë foljore» (f. 166)⁵³.

Por më tutje Gabinski ka shprehur mendimin se togu i tipit *për të bërë* në funksionin kryesor (qëllimor) nuk është i desintaksizuar, pasi parafjala *për* këtu e ruan kuptimin e saj qëllimor, sepse: 1) Pas saj, në vend të emrit prejparticipor asnjans, mund të përdoret sinonimi i tij joprejparticipor, natyrisht duke zëvendësuar kallëzoren me gjindoren e objektit dhe ndajfoljen me mbiemrin. 2) Togu i tipit *për të bërë* mund të përdoret paralelisht me togun e tipit *për* + emër joprejparticipor veprimi. P.sh. Ishte dërguar me një brigadë vullnetare *për sqarim politik dhe për të rregulluar* çështjen e vullnetarëve (Gjata, K., 174). (f. 202-203; shih edhe f. 239-240).

Në bazë të të njëjtave kritere togu i tipit *për të bërë* nuk do të rezultonte i desintaksizuar edhe në funksionin atributiv⁵⁴ të tipit *ambicja për të pasur* çdo gjë në dorë... (Spasse, APF, 141) (f. 219).

Gjithashtu, duke u mbështetur në këto kritere, në ndërtimet e tipit *është* + *për të bërë* ai e pranon desintaksizimin e togut të tipit *për të bërë* vetëm atëherë kur ato ndërtime «shprehin jo marrëdhënje qëllimore, por vetë domosdoshmërinë për veprim» (f. 233).

Po sipas këtyre kritereve, togu i tipit *për të bërë* në ndërtimet tautologjike të tipit *për të korr[ë] kishte korr* mund të merret më fort i desintaksizuar, pasi ndërtimet tautologjike të tipit *për* + emër çfarëdo (p.sh. *për kungull, kungull s'është*... KPB, 123) haset rrallë (f. 225-226). Përkundrazi, në ndërtimet tautologjike, që paraprihen nga *sa*, ai mendon se togu i tipit *për të bërë* nuk është i desintaksizuar, sepse *të bërë* në këtë rast paraprihet nga «po ai element (*sa për*), me të cilin formohen lirisht plotës marrëdhënjeje në bashkim me emra të çdo përkatësie fjalëformuese» (p.sh. *Sa për* grurin që ka mbetur në arë, ju kini të drejtë — Gjata, K, 343).

Sipas Gabinskit, togu i tipit *për të bërë* paraqitet i desintaksizuar dhe me vlerë paskajoreje në ato raste kur përdoret:

a) Në rolin e kryefjalës pas foljesh a shprehjesh pavetore në ndërtime të tipit: *Është e lehtë për të bërë* këtë gjë (f. 207 v.); *Nuk ishte një punë e vështirë për t'i diktuar* cerdhet e gargujve — Shuteriqi, G., 83 (f. 213 v.); *Vlen për të theksuar* rastin e një plaku tetëdhjetëvjeçar — Peçi, 6 (f. 217); Por dua të di se mos *kushton* shumë *për të gatuar* — Noli, DK, 65 (f. 217); *I mbetej* vetëm *për të rregulluar* çatinë e kosheres — Gjata, P, 55 (f. 218); *më vjen për të qeshur*... (f. 220 v.)

b) Në funksione të varura; p.sh. në ndërtime të tipit Detin do ta çajmë me këmbë dhe do të vete ta vras, ama *për të shkruajtur* nuk mund, jo! — Zaloshnja, K, 52 (f. 229 v.). Ndërtimet e këtij tipi, sipas autorit, kanë dalë nga ndërtimet tautologjike nëpërmjet elipsës.

c) Në ndërtime të tipit *kam për qëllim* + *për të bërë* (f. 234-235).

d) Në ndërtime të tipit *kam* (ose *më bie*) *ndër mend për të bërë* diçka (analogjike sipas përdorimit si paskajore në pozicione të tjera) (f. 235);

53) Këtu autori bie në një pozitë të ngjashme me atë që bën objekt kritike në f. 21, ku kritikon përdorimin e termave të tilla si «folje e plotvlershme», «folja në kuptimin e mirëfilltë» etj., duke vërejtur me të drejtë se nga këto del sikur mund të ekzistojnë edhe folje «jo të plotvlershme» ose «në kuptimin jo të mirëfilltë».

54) Autori nuk shprehet shkoqur për vlerën e togut të tipit *për të bërë* në këtë funksion, por pak më poshtë shton se ky tip ndërtimi bën pjesë në modelin *për* + emër në përgjithësi dhe jep edhe shembëllën. Dëshira për rezultate të mira... (Shih edhe f. 233).

kur *mësova për të shkruar*;... nuk lejonte për t'i kushtuar të njëjtën vëmendje rritjes..., etj. (f. 236).

Në f. 223-228 ai rendit edhe një numër rastesh, në të cilat paraqitet i mundshëm infinitizimi i togut të tipit *për të bërë* «në pozicione të dykuptimshme». P.sh.

Për të shpëtuar! Për këtë u dëgjua përtej nesh fjala e sulmit... — Bedo, ZM, 98 (F. 224).

— *Po për të dalë?* — pyet Kujtimi. — Canaj, JZÇ, 46 (f. 224).

— *Për të shkatërruar*, thua ti?... — Marko, QF, 356 (f. 225).

* * *

Sipas Gabinskit, togu i tipit *për të bërë* i desintaksizuar, është ndeshur vetëm nja 80 herë⁵⁵ në më shumë se 27.000 faqe (shumica në literaturën e pasluftës). (f. 241).

* * *

Në parim, ne pajtohemi me mendimin e Gabinskit se, për të kaluar një tog parafjalor në klasën e foljevet, duhet që më parë emri i këtij togu të jetë desubstantivuar, dhe se desubstantivimi i emrit në këtë rast përftohet me anë të humbjes së sintaksësisë. Por ne nuk pajtohemi me mënyrën se si e kupton ai në këtë rast humbjen e sintaksësisë. Sipas tij, një tog parafjalor e humbet sintaksësinë «duke rënë në pozita, ku nuk shprehen lidhjet e dhëna me fjalë të tjera» (f. 186). Duke e kuptuar në mënyrë të tillë të ngushtë dhe të njëanshme humbjen e sintaksësisë prej togut parafjalor, ai ka rënë shpesh në pozita të pambrojtshme. Si lexon gjithë kapitullin kushtuar togut të tipit *për të bërë*, njeriut i lindin një sërë pikëpyetjesh për probleme të krijuara artificialisht nga zbatimi mekanik i një kriteri, që duket sikur shkencërisht është në rregull. Dhe në të vërtetë nuk ka se si të mos çuditet njeriu, kur sheh se si rrjedhim i zbatimit mekanik të një kriteri të tillë, i njëjti tog parafjalor, i përdorur me të njëjtin funksion, në një rast interpretohet si i desintaksizuar, kurse në një rast tjetër interpretohet si i padesintaksizuar. Mjafton të kihet parasysh rastet kur ky tog përdoret pas foljes *është* me funksion predikativ, ose kur përdoret në funksion tautologjik, paraprirë ose jo nga pjesëza *sa* (shih më sipër). Le të sjellim edhe një shembëll. Duke shqyrtuar ndërtimet e tipit *e kam të vështirë për të bërë diçka* (f. 230 v.), Gabinski pohon se në këto ndërtime *për të bërë* mund të interpretohet dy mënyrësh. Po të merret trajta e shkurtër e si përsëritëse e kundrinës, atëhere, *për të bërë* (në funksion kundrinor) është e desintaksizuar. Por, në rast se ajo interpretohet si «e gënjeshtërt» [= pleonastike — Sh. D.], si p.sh. në shprehjet frazeologjike të tipit *ia marr këngës etj.*, atëhere *për të bërë* nuk është e desintaksizuar (f. 231-232).

Nga mënyra se si vepron Gabinski, del se desintaksizimi i togut parafjalor në shqyrtim dhe si rrjedhim, edhe desubstantivimi i emrit prejfol-

55) Në shën. 2 në fund të f. 241 ai thotë se në këtë shifër nuk ka përfshirë as 76 rastet e përdorimit të togut të tipit *për të bërë* në ndërtime tautologjike (sepse «të dykuptimshme») «si edhe faktet e leksikalizimit të tipit *është për të...* prej foljesh që shprehin të treguar dhe të çmuar dhe të modelit *më vjen për të...* si edhe rastet e desintaksizimit statistik të mundshëm».

gor asnjë, që bën pjesë në të, konsiston vetëm në desinantizimin e parafjalës *për*. E kjo duket qartë nga këto mendime të tij: Sipas tij, togu i tipit *për të bërë* është i desinantizuar vetëm në ato raste kur përdoret në funksione, që në gjuhën shqipe nuk shprehen me anë të parafjalës *për*. Për të në këtë rast kjo është gjithshka. Fakti që emri prejfoljor asnjë në këtë tog nuk mund të përdoret më në trajtë të shquar, nuk mund të përcaktohet nga një mbiemër dhe nga një emër në gjindore, sipas tij, nuk është një shenjë e desinantizimit të emrit, në rast se togu, ku ky bën pjesë, nuk përdoret në funksione, që s'janë karakteristike për të si tog parafjalor. As reksioni vetëm i kallëzores dhe shoqërimi vetëm me ndajfolje, as dallimi formal i diatezavet, madje as edhe dallimi i paqenë i kohës relative⁵⁶, nuk janë për Gabinski shenja desinantizimi dhe verbalizimi të togut të tipit *për të bërë*, në rast se ky nuk përdoret në funksione, që s'janë karakteristike për të si tog parafjalor.

Që Gabinski çështjen e desinantizimit të togut parafjalor në shqyrtim e kufizon vetëm tek parafjala, kjo duket edhe në faktin që ai, për të argumentuar se *për të bërë* në funksionin kryesor (qëllimor) nuk është desinantizuar, parashtron dy arsye, që theksin e vënë pikërisht mbi parafjalën. Mungesën e desinantizimit në këtë rast ai e argumenton me faktin që pas parafjalës *për* në funksion qëllimor mund të përdoret edhe një emër tjetër joprejjparticipor, natyrisht duke zëvendësuar kallëzoren me gjindoren e objektit dhe mbiemrin me ndajfolje. Si arsye të dytë, për të forcuar të parën, ai parashtron faktin që këta dy tipa ndërtimesh mund të përdoren paralelisht pranë njëri-tjetrit. Me fjalë të tjera, sipas tij, në këtë rast për humbjen apo ruajtjen e sintaksësisë së këtij togu parafjalor nuk ka rëndësi ndryshimi esencial i lidhjevet sintaksore të emrit, që është pjesa përbërëse themelore e tij, as të përfuturit e tipareve formale karakteristike për foljen, por humbja apo ruajtja e kuptimit qëllimor të elementit parafjalor.

Veç kësaj, për ne mbetet e paqartë përse Gabinski, pasi është orvatur të provojë se togu i tipit *për të bërë* në funksionin themelor nuk është desinantizuar, pohon se ky tog «demonstron me siguri vetëm shenja të përbashkëta pjesësh të ndryshme të ligjëratës — të emrit dhe të foljes ose, më konkretisht, të emrit të veprimit dhe të një forme të pashtjellë foljore» (f. 166). Emri (i çfarëdo tipi fjalëformues), në rast se nuk është desinantizuar, në çfarëdo togu parafjalor duhet të ruajë veçoritë e tij substantivore dhe s'ka përse të marrë edhe tipare morfologjike e sintaksore karakteristike për foljet. Përndryshe, ai duhet konsideruar i desubstantivuar.

Është e vërtetë se në një tog parafjalor roli i parafjalës si shprehëse e raportit sintaksor është me rëndësi. Por, nga ana tjetër, nuk është më pak e vërtetë se funksionin sintaksor e kryen i gjithë togu, ku emri është pjesa përbërëse kryesore. E desinantizimi i një togu parafjalë + emër në analizë të fundit është desinantizimi i vetë emrit, i cili humbet në këtë rast veçoritë morfologjike dhe lidhjet sintaksore karakteristike për të. Prandaj çështja e ruajtjes apo e humbjes së substantivitetit të emrit në këtë rast duhet vendosur në bazë të ruajtjes apo humbjes së veçorivet morfologjike dhe lidhjevet sintaksore të vetë atij (emri).

Veç kësaj, nga arsyetimet e Gabinskit edhe një çështje tjetër nuk del e qartë. Si ka qenë e mundur që togu i tipit *për të bërë* ka arritur të

56) Forma e tipit *për të pasë bërë*, që figuron në disa gramatika, si në atë të Kristoforidhit (f. 104, 123 etj.), të K. Cipos (f. 130 etj.) në të vërtetë nuk përdoret.

përdoret në funksione sintaksore të tilla (si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror, si kryefjalë, si kundrinë e drejtë etj.), që s'janë karakteristike për të si tog parafjalor, në rast se ai nuk do të kish qenë i desintaksizuar dhe i verbalizuar? A do të kish lejuar ndjenja gjuhësore e shqipfolësit përdorimin e një togu parafjalor të padesintaksizuar dhe të paverbalizuar në funksionet e lartpërmendura? E njëjta pyetje mund të bëhet edhe për format perifrastike të së ardhmes dhe të kushtores të sajuara me pjesëmarrjen e formës perifrastike të tipit *për të bërë*. Gabinski, megjithëse e ka njohur vlerën foljore (si kohë e ardhme dhe si kushtore) të formave perifrastike të tipit *kam për të bërë* dhe *kisha për të bërë* (f. 161, 196), nuk shprehet shkoqur për përkatësinë kategoriale të *për të bërë* në këto forma perifrastike. A mendon ai se edhe në këtë rast tipi *për të bërë* ka hyrë në formën perifrastike të së ardhmes dhe të kushtores si një tog parafjalor i padesintaksizuar dhe i paverbalizuar⁵⁷.

Këtu atij i ka shpëtuar edhe një veçori sintaksore me shumë rëndësi. Forma perifrastike e tipit *për të bërë*, sidomos kur përdoret në funksion qëllimor, mund të marrë edhe një kryefjalë të ndryshme nga ajo e foljes së fjalisë drejtuese. P.sh.

...veçë jet për t'u dītunë moti kur ka me kjanë. «...resta solo di sapere il tempo quando ha da essere». (Bogdani, C. Pr., pj. II, IV/IV/8)... të cilënë Sulltan Mehmeti e ka mbyllurë me paditurit të ti për të mos hyrë aniet e Venecanëvet...; Për të ndërtuarë kjo fushë duhetë të hapenë lumenjtë... (S. Frashëri, Shqipëria... 80, 79); Për të mos i mbetur hatri askujt, përfundoi ta thërrësë Kuvendin e Kapedanëve në Lesh... (F. Noli, H. SK., 32)..., e kaloi në të ndarën tjetër, pas banakut, që dyqanxhiu e ruante për të pirë rredhi e shokëria etj... (J. Xoxa, Lumi, III/35).

Po të mbështeteshim në kriterin e Gabinskit, edhe në këtë rast togu e tipit *për të bërë* në funksion qëllimor duhej ta konsideronim të padesintaksizuar dhe të paverbalizuar dhe, si rrjedhim, të pranonim që në gjuhën shqipe ka togje parafjalore, që mund të marrin kryefjalë, pra, që shërbejnë si kallëzues në kuptimin e gjërë të fjalës.

Në vlerësimin kategorial të togut të tipit *për të bërë* Gabinski ka identifikuar kriterin e desintaksizimit dhe të verbalizimit të këtij togu me atë të përcaktimit nëse ky tog ka vlerën e paskajores apo jo. Këto janë dy gjëra të ndryshme, ndonëse jo pa lidhje midis tyre, sepse, kur një tog parafjalor ka marrë vlerën e një paskajoreje, ai është pa tjetër edhe i desintaksizuar dhe i verbalizuar. Por ka edhe raste që një tog parafjalor paraqitet i desintaksizuar dhe i verbalizuar e, megjithatë, nuk ka vlerën e paskajores, si p.sh. togu i tipit *me të bërë* në ndërtime të tipit *Me të shkuar* Hajredin Pasha, kapedanët e Myzeqesë i dbuan turqit nga Berati... (F. Noli, H.Sk., 9).

Gjithashtu, ne mendojmë se duhet bërë dallimi midis desintaksizimit të një togu parafjalor dhe verbalizimit të tij, sepse një tog parafjalor i tipit parafjalë + emër prejfoljor asnjans, kur desintaksizohet, nuk ka-

57) Ja si shprehet ai: «Së fundi, *për* e desemantizuar mund të hyjë në përbërjen e formave gramatikore prejinfinitivale, dhe pikërisht të së ardhmes dhe të mënyrës kushtore.» (f. 196).

Sipas mendimit tonë, format e tipit *kam për të bërë* dhe *kisha për të bërë* kanë dalë nga togfjalëshat e tipit *kam (kisha) + për të bërë* në funksion kallëzuesor, d.m.th. *kam për t'i dhënë* (diçka diku) ka dalë nga *kam* *diçka për t'i dhënë* diku. Për analogji me këtë është formuar edhe forma e tipit *kisha për të bërë*, e cila në origjinë (ashtu si format e tipit *do të bëja* dhe *kisha me ba*) ka qenë një e ardhme e së shkuarës, kurse sot përdoret edhe me funksionin e mënyrës kushtore.

lon pa tjetër në klasën e foljevet, në rast se nuk ka marrë tipare foljore. P.sh togjet parafjalore të tipit *me të përtuar, me të qeshur, me të qarë* etj., ndonëse janë të desintaksizuara, nuk kanë kaluar në klasën e foljevet, por në atë të ndajfoljeve.

Sipas mendimit tonë, desintaksizimi i një togu parafjalor konsiston në humbjen e veçorivet morfologjike dhe sintaksore nga ana e emrit, që bën pjesë në të, gjë që me kohë sjell dhe desemantizimin e parafjalës përkatëse. Kurse verbalizimi i këtij togu të desintaksizuar konsiston në marrjen e veçorive semantike, morfologjike dhe sintaksore karakteristike për foljet. Këto dy procese, që plotësojnë njëri-tjetrin, mund të konkretizohen fare mirë me formën perifrastike të tipit *për të bërë*.

Desintaksizimi i togut parafjalor të tipit *për të bërë* konsiston në atë që emri prejfoljor asnjans ka humbur aftësinë për t'u përdorur në të dy trajtat dhe për t'u përcaktuar nga një mbiemër ose nga një emër në rasën gjindore⁵⁸. Në të tilla rrethana edhe tiparet e tjera gramatikore të tij zbehen e kështu përftohet desubstantivimi i tij i plotë e, bashkë me të, edhe zbehja kuptimore e parafjalës *për*. Këtë proces desintaksizimi, sipas mendimit tonë, e kanë lehtësuar edhe këta dy faktorë: 1) Emrat në gjuhën shqipe pas disa parafjalësh vihen zakonisht në trajtë të pashquar, edhe kur kuptimisht janë të shquar⁵⁹. 2) Emrat e veprimit të tipit *të bërë* në trajtë të pashquar, të paparaprirë nga nyja *një* ose nga ndonjë përcaktor tjetër, rregullisht, nuk shoqërohen me mbiemra ose me emra në rasën gjindore⁶⁰.

Togu i tipit *për të bërë*, i desintaksizuar, potencialisht i kishte të gjitha mundësitë për të marrë tiparet semantike dhe gramatikore të një forme të pashtjellë foljore. Emri prejfoljor asnjans semantikisht është shumë afër paskajores, pasi ashtu si paskajorja ai emërton një veprim ose gjendje në mënyrë të pacaktuar. Nga pikëpamja gramatikore, duke qenë se në togun e tipit *për të bërë* ai nisi të humbiste aftësinë e lidhjeve substantivore, me kohë e zhvilloi më tej aftësinë e lidhjeve foljore, që tek emrat prejfoljorë asnjans janë vetëm sekondare dhe fakultative. Këtu është fjala për reksionin e kundrinës së objektit dhe për shoqërimin me ndajfolje. Kjo dukuri, sipas mendimit tonë, shënoi hapin e parë drejt verbalizimit të plotë të këtij togu, që me kohë do të mernte në mënyrë të pashmangshme edhe tipare të tjera foljore si përdorimin jo vetëm me kundrina të drejta por edhe me kundrina të zhdrejta, duke u shprehur këto, ashtu si tek gjithë format e tjera foljore, edhe me anë trajtash të shkurta të përemravet vektorë⁶¹, si edhe përdorimin me një kryefjalë të ndryshme nga ajo e foljes së fjalisë drejtuese. Në një fazë më të vonë në togun e verbalizuar të tipit *për të bërë*, për analogji me format e tjera të pashtjella foljore, u dallua formalisht edhe diateza pësore-vetvetore me anë të pjesëzës përemërore *u*⁶².

58) Do pasur parasysh se në ndërtimet e tipit... *për të mësuarit* [sot më shpesh: *për mësimin* — Sh.D.] e shkrim-këndimit... (f. 240) togu parafjalor *për të mësuarit* është kualitivisht i ndryshëm nga togu i verbalizuar... *për të mësuar* shkrim-këndimin.

59) Shih Pedersen Festschrift til Vilhelm Thomsen, 255.

60) Ndërtimi i tipit *për të ngjallun të ri* t'atdheut të mjerë (Skירו, CT, 531), që citon Grabinski në f. 164, nuk është normal në shqipen e sotme.

61) Përdorimi i trajtave të shkurtra me formën e tipit *për të bërë* dëshmohet që në veprën e Bogdanit.

62) Në gegërishte forma e tipit *për t'u bërë* dëshmohet që në veprën e Bogdanit. Kurse në toskërishte kjo formë është e vonë, kryesisht e shek. XX, ndonëse gjurmë hasen edhe në veprën e Th. Mitkos (1879).

Një nga pasojat e verbalizimit të këtij togu është edhe shkrirja e plotë e të dy pjesëvet të tij përbërëse — parafjalës *për* dhe emrit prej-foljor asnjans — në një fjalë të vetme si formë perifrastike.

Kjo formë e pashtjellë foljore ka ardhur duke e zgjëruar sferën e funksionevet të saj, duke u përdorur, ndër të tjera, edhe në funksionin kallëzuesor e sporadikisht edhe në funksionin kundrinor e kryefjalor. Si këto ashtu edhe funksionet e tjera të saj përfshihen në sferën e funksionevet të paskajores, prandaj ne edhe e kemi quajtur formë perifrastike të pashtjellë me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara⁶³. Ajo, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë⁶⁴, është e mbarë shqipëse dhe jo vetëm e toskërishtes, siç e kanë paraqitur disa. Por në toskërishte ajo ka një përdorim më të dendur, sepse në këtë dialekt ajo nuk konkurohet nga paskajorja e tipit *me ba*. Ajo është e vetmja formë e pashtjellë foljore, që mund të quhet konvencionalisht «paskajore e dytë e shqipëse»⁶⁵, e krahasueshme me rumanishten *de făcut*. Në këto rrethana është fare i panevojshëm krahasimi që bën Gabinski me formën e tipit *së bëri*, të cilën ai pa të drejtë e konsideron gjithashtu si një formë të pashtjellë foljore, madje si një paskajore *in statu nascendi*.

IV

RRETH VLERËS SË FORMËS SË TIPIT SË BËRI

Në kapitullin e dytë të veprës së tij (f. 80-160) si edhe në punime të mëparshme M. A. Gabinski është përpjekur të argumentojë vlerën foljore të formës së tipit *së bëri* në togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* dhe *u lodha së foluri*. Ai kritikon (f. 83-93) të gjithë ata që e kanë trajtuar atë si një formë emërore në rasën rrjedhore të pashqar njëjës. Duke u mbështetur në materialin e vjelë, ai arrin në përfundimin se forma e tipit *së bëri* përdoret më fort në togfjalësha me raport kundrinor të tipit *mbarova së foluri* (në gjithë materialin e vjelë prej 27. 326 faqesh ka nxjerrë 369 raste të një përdorimi të tillë nga 647 gjithsej të përdorimit të formës së tipit *së bëri*), relativisht më pak në togfjalësha me raport shkakor të tipit *u lodha së foluri* (në gjithë materialin e vjelë ai ka nxjerrë 163 raste të një përdorimi të tillë⁶⁶) dhe vetëm rrallë e tek me vlerë përcjellorje në togfjalësha të tipit... po gjith jetën e tij prej burri e kish çuar *së munduari* botën, *së vrari e së preri*, *së djeguri e së rrahuri* (Shuteriqi, Çl. II. 344). Sipas tij, ajo haset më të rrallë edhe si formë emërore reliktoze në ndërtime të tipit si ara me mi-sër pas *së prashituri* e pas vaditjes (shih. f. 123 v.).

Për të vërtetuar vlerën foljore të formës së tipit *së bëri*, të cilën arrin ta quajë edhe një paskajore *in statu nascendi* (f. 144-5), Gabinski parashtrohet këta argumenta:

63) Shih «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», 220.

64) *Po aty*, 220.

65) Duke marrë si «paskajore të parë» atë të tipit *me ba* të gegërishtes, por pa nënkuptuar domosdo që këtë të fundit e ka pasur pa tjetër edhe toskërishtja dhe që para saj shqipja nuk ka pasur ndonjë paskajore tjetër, siç pohon Gabinski në mënyrë-kategorike.

66) Në të vërtetë ai ka hasur 259 raste togfjalëshash me raporte shkakor, por nga kjo shifër ka zbritur 96 raste të tipit *u meka së qeshuri*, që i quan frazeologjizma.

1) Në togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* dhe *u lodha së foluri* forma e tipit *së bëri* është e desubstantivuar, për arsye se ajo përdoret në një funksion, që nuk shprehet me anë të rasës rrjedhore pa parafjalë (f. 81). Këtë mendim ai e argumenton edhe me këto arësytetime:

a) Raporti kundrinor në shqipen e sotme nuk shprehet me anë të rrjedhores së pashquar pa parafjalë, por me anë të kallëzores pa parafjalë. Të pranosh ekzistencën e rasës rrjedhore në togfjalëshin e tipit *mbarova së foluri*, sipas tij, do të thotë që një rasë mund të përdoret «vetëm në caqet e një grupi fjalëformues (dhe jo semantik) emrash, gjë që në fakt e përjashton ekzistencën e rasës, d.m.th. të një forme gjithëgramatikore, përdorimi i së cilës është i pavarur nga faktorët fjalëformues.» (f. 106-107).

Edhe raporti shkakor, shton ai, nuk shprehet me anë të rrjedhores pa parafjalë, por me anë togjesh parafjalore. Edhe në togfjalëshat e tipit *vdës urie*, *ngordh së ftohti* format e tipit *urie*, *së ftohti* etj. «në stilin neutral bashkëkohor të gjuhës e kanë humbur karakterin e përgjithshëm gramatikor (общеграмматичность) si një veti e pandashme e rasës dhe për këtë arsye janë shndërruar në ndajfolje» (f. 111). Në një rast tjetër (f. 116) ai pohon se rrjedhorja e shkakut në shqipen e sotme është një «mënyrë poetike» e rrallë.

b) Në togfjalëshat në shqyrtim forma e tipit *së bëri* nuk mund të përdoret në trajtë të shquar, as në numrin shumës dhe as mund të zëvendësohet me formën femërore përgjegjëse (f. 108) [p.sh. plasi *së qeshure* nuk thuhet — Sh.D.I].

c) Në këta togfjalëshat forma e tipit *së bëri* nuk mund të zëvendësohet me rrjedhoren e një emri prejfoljor prapashtesor ose të një emri tjetër veprimi, p.sh. — *së vrapuari* me *vrap* (ose edhe me *vrapimi* — Sh.D.I); dhe as mund të përdoret krahas tyre, p.sh. në vend të *U lodh së shkruari* e *së kënduari* nuk thuhet dot *U lodh së shkruari* e *këndimi*. (f. 105-106).

ç) Forma në shqyrtim ka humbur aftësinë për t'u përcaktuar nga një mbiemër ose nga një emër në rasën gjindore, d.m.th. ka humbur aftësinë e lidhjevet emërore (f. 108, 121).

2) Në togfjalëshat në shqyrtim forma e «desubstantivuar» e tipit *së bëri* funksionalisht ka marrë tiparet e një forme foljore të pashtjellë e kjo dëshmohet nga këto dy fakte:

a) Karakteri i përgjithshëm gramatikor, d.m.th. aftësia për t'u formuar nga çdo folje (f. 119, 130).

b) Marrja e një kundrine të drejtë në rasën kallëzore nga një veti fakultative e emrit prejparticipor tek forma e tipit *së bëri* është shndërruar në «një normë të domosdoshme». (f. 82, 130).

Gjithashtu ndajfolja, nga zëvendësuese fakultative e mbiemrit tek emrat prejparticiporë, tek forma e tipit *së bëri* është shndërruar në vetmin variant të lejueshëm». (f. 121).

3 Megjithëse, sipas Gabinskit, «individualizimi material ashtu si edhe dallimi i kategorivet josintaksore, të domosdoshme për format e shtjella (finite), nuk hyjnë në vetë minimumin e tiparevet, që formojnë foljen e pashtjellë», formës së tipit *së bëri*, gjithnjë sipas tij, nuk i mungojnë edhe këto veçori. Ja si e argumenton ai këtë:

a) Formalisht *së bëri* me formën arkaike të nyjes së përparme (së) është diferencuar nga rrjedhorja e emrit prejparticipor, që ka nyjen e përparme të (*të bëri*). (f. 131).

b) Nuk mungojnë raste sporadike që forma e tipit *së bëri* përdoret

me pjesëzën përemërore *u*, karakteristike për diatezat pësore-vetëvetore, ndonëse në një masë shumë më të kufizuar se format e tjera të pashtjella të foljes (f. 140-141). Sidoqoftë, ai mendon se forma e tipit *s'u bëri* ka perspektivë të zhvillohet më tej në gjuhën shqipe. (f. 142 v.).

Gabinski mendon gjithashtu se, «po të lindi një domosdoshmëri e veçantë për të shprehur kohën e kryer», mund të krijohet, në kushte të ngjashme me *t'pasunit klënë*⁶⁷, edhe koha e kryer e tipit *së pasuri qenë* (f. 126).

Duke u mbështetur në sa më sipër, autori arrin në këtë përfundim: «Pra, tipi *së bëri* është një formë e pashtjellë e foljes shqipe, e cila si e tillë, përveç minimumit të domosdoshëm të tipareve, ka edhe një karakteristikë formale të veçantë si edhe dallimin sporadik të diatezave» (f. 144).

Sadoqë e pranon se forma e tipit *së bëri* përdoret në funksione të kufizuara, Gabinski parashikon shtimin e përdorimit të saj «si në përgjithësi ashtu edhe në funksionin e saj themelor të tashëm» (f. 143).

Ai supozon se «shtimi i dukshëm i përdorimit të formës së tipit *së bëri* (sidomos në funksionin e saj themelor, që është më shpesh sinonim me paskajoren) në periudhën e pasluftës, kur *së bëri* u individualizua materialisht, mund të ketë lidhje me ndërprerjen relativisht të vonë (fillimi i shek. XX⁶⁸) të ndikimit grek mbi toskërishten (nëpërmjet shkollës dhe kishës ortodokse dhe nëpërmjet bilinguizmit të përditshëm në disa rajone) dhe, lidhur me këtë, edhe me mënjanimin e mbështetjes së huaj për mënyrën lidhore të shqipes» (f. 154).

Megjithëse pohon (f. 156) se «tipi *së bëri* në kohën e tashme nuk mund të konsiderohet si paskajore», për arsye se nuk mund të përdoret në funksione të pavarura, pak më poshtë ai nxjerr një tjetër përfundim. Si pohon se desintaksizimi mund të vërtetohet edhe në funksione të varura (f. 156), ai shton se, kur këto bëjnë pjesë në sferën e përdorimeve të paskajores, atëhere forma e desintaksizuar me vlerë foljore në bazë «të ligjit gjithëgjyhesor të paskajores» me kalimin e kohës merr edhe funksione të tjera infinitivale duke përfshirë edhe funksionet e pavarura (f. 157). Duke u mbështetur në shtrirjen e gjersotme të përdorimit të formës së tipit *së bëri* edhe pas foljesh durative dhe inkoative, autori parashikon një shtrirje të mëtejshme të funksioneve të saj, duke përfshirë edhe funksionet e pavarura (f. 158-159). «Kjo do ta lejonte tipin *së bëri* të konsiderohet pikërisht paskajore dhe jo vetëm një nga format e pashtjella të foljes.» (f. 159).

Në shënimin 3 të f. 158 Gabinski parashikon një «dobësim të mëtejshëm të funksionit shkakor të *së bëri*», për arsye se, nga njëra anë, paskajorja e shkakut nuk i përket sferës gjithëgjyhesore të paskajores dhe, nga ana tjetër, funksioni shkakor i formës së tipit *së bëri* në shumicën e rasteve semantikisht është i afërt me funksionin themelor (kunderinor) të saj. Në shënimin 6 të f. 160 ai propozon që forma e tipit *së bëri* në mënyrë paraprake të quhet *terminativ* në bazë të funksionit themelor të saj — shenjimit të caktuar të veprimit.

Në pjesën VI të kapitullit të dytë, kushtuar parahistorisë dhe historisë së formës së tipit *së bëri*, ai ka shfaqur mendimin se «pikënisjet e evolucionit të *së bëri*, të përfaqësuara nga përdorimi rasor parafoljor

67) Për këtë shih vërejtjet tona më sipër në pjesën II.

68) Më parë autori paska menduar se ndikimi i greqishtes mbi toskërishten ishte pakësuar që para shek. XVI (f. 154).

i emrit prejparticipor të veprimit, duhet të kenë qenë jo më pak se dy. Të paktën, versioni, sipas të cilit të gjitha përdorimet e *së bëri* i përkasin, qoftë edhe diakronikisht, rrjedhore së shkakut, paraqitet më pak i mundshëm». (f. 145).

Sipas tij, funksioni gjerundiv ka dalë nga funksioni shkakor (f. 146), kurse për funksionin themelor (kundrinor) ai shkruan: «Në lidhje me këtë është e natyrshme të supozohet origjina e pavarur e përdorimit themelor të *së bëri* nga ndonjëri prej kuptimevet rasore të rrjedhore, me përjashtim të kuptimit shkakor.» (f. 147).

* * *

Sipas mendimit tonë, argumentat e parashtuar nga Gabinski për të vërtetuar desubstantivimin e formës së tipit *së bëri* dhe përdorimin e saj si një formë e pashtjellë foljore, madje edhe si një paskajore in statu nascendi, nuk i qëndrojnë kritikës.

Në radhë të parë do vënë në dukje se ai nuk ka marrë parasysh faktin që në shqipen e sotme (dhe jo vetëm në gjuhën shqipe) mbijetojnë edhe disa tipa ndërtime arkaike, që natyrisht e kanë humbur gjallërinë e dikurshme. Të tillë janë, ndër të tjera, edhe togfjalëshat e tipit folje + emër në rrjedhore me raport shkakor (p.sh. *plasa vape, u lodha së foluri* etj.) si edhe folje + emër prejparticipor me raport kundrinor⁶⁹ (p.sh. *mbarova së foluri*). Argumentat e parashtuar nga Gabinski, për të vërtetuar desintaksizimin e rrjedhore pa parafjalë dhe, si rrjedhim, edhe desubstantivimin e vetë emrit, dëshmojnë vetëm karakterin arkaike të togfjalëshave në shqyrtim, të cilët nuk mund të kenë zhdërvjelltësinë e togfjalëshave që i kanë zëvendësuar ata, d.m.th. të togfjalëshave të tipit folje + parafjalë + emër, përkatësisht folje + emër në rasën kallëzore.

Fakti që në togfjalëshat e tipit *plasa vape* (me raport shkakor) emri në rasën rrjedhore zakonisht nuk përdoret në trajtë të shquar⁷⁰, as në numrin shumës dhe as nuk mund të përcaktohet nga një mbiemër, nuk flet për desintaksizimin dhe desubstantivimin e tij dhe, si rrjedhim, për kalimin e tij në klasën e ndajfoljevet, siç pretendon Gabinski⁷¹ (f. 111 v.). Po të kishin kaluar në klasën e ndajfoljevet, emrat e këtyre togfjalëshave duhej të kishin pësuar edhe një farë evolucioni semantik (zgjerim ose ngushtim kuptimi), ashtu siç kanë pësuar rrjedhoret e adverbializuara *fare, heret, krejt* ose kallëzoret e adverbializuara *mot, vjet*⁷², dhe rre-

69) Në krijimet popullore si edhe në shumë të folme hasen edhe sot ndërtime të tipit folje transitive + *asi* (ose *aso*) + emër në rasën rrjedhore (me raport kundrinor). P.sh. *s'kam parë (s'më kanë zënë sytë) asi njeriu*. Ja edhe një shembëll nga këngët popullore: Ky gjaksori bani be: «Njeksi trimash kurr s'kam pre!» (*Këngë popullore historike*, Tiranë, 1956, f. 113).

70) Ai ka shënuar edhe disa shembëlla me emrin në rasën rrjedhore të shquar (f. 116).

71) Krahasimi me ndërtimet e gjermanishtes të tipit *Hungers sterben* (f. 117), sipas mendimit tonë, nuk qëndron, sepse në gjermanishte *-s*, në të tilla raste është shndërruar në një formant abverbializues, që e marrin edhe emri femëror *Nacht (Nachts)* si edhe ndajfolje të tipit *meinerseits, allerseits* etj. (Shih H. Paul, *Deutsche Grammatik*, III, 372). Kurse në ndërtimet arkaike të greqishtes të tipit *πεδάλω τῆς πείνας* gjymtyra e dytë mbetet një emër në gjindore të shquar, d.m.th. i paadverbializuar.

72) Sipas mendimit tonë, edhe format e kallëzores së shquar *ditën, natën* ose të rrjedhore së shquar *verës, dimrit, rrugës* etj. nuk i kanë humbur lidhjet substantivore (mund të përcaktohen nga mbiemra dhe emra në gjindore; format e rre-

dhimisht përdorimi i tyre nuk do të mbetet i kufizuar vetëm në togfjalësha me karakter frazeologjik, ku gjymtyra e parë (folja) ka një kuptim të figurshëm, pra, stilistikisht joneutral. Nga ana tjetër, siç e ka pohuar edhe vetë Gabinski, në shqipen e sotme, sidomos në stilin poetik, hasen edhe ndërtime të tjera me rrjedhore shkaku pa parafjalë. Të gjitha këto, sipas mendimit tonë, dëshmojnë vetëm këtë që togfjalëshat me rrjedhore pa parafjalë (me raport shkaku) në shqipen e sotme janë bërë arkaikë, prandaj edhe sfera e përdorimit të tyre është mjaft e kufizuar.

Nga ana tjetër, siç e ka konstatuar edhe vetë Gabinski, rrjedhorja pa parafjalë në gjuhën shqipe dikur ka qenë përdorur edhe në funksione të tjera, që sot shprehen me togje parafjalore, (parafjalë + emër në rrjedhore ose emërore). Kështu, ndërsa kundrina e drejtë sot shprehet rregullisht me anë të një emri në rasën kallëzore, ajo dikur duhet të ketë qenë shprehur edhe me anë të rasës rrjedhore pa parafjalë⁷³. Gjurmë të këtij përdorimi tashmë arkaik vihen re jo vetëm tek togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* por edhe tek togfjalëshat e tipit *s'kam parë* (s'më kanë zënë sytë) *asi njeriu* etj., që nuk janë fort të rrallë, sidomos, në shqipen popullore⁷⁴.

Edhe fakti që forma e tipit *së bëri* në togfjalëshat e tipit *u lodha së foluri* dhe *mbarova së foluri* përdoret vetëm në trajtë të pashquar njëjës, pa pasur mundësi të përdoret në shumës, as të zëvendësohet me formën përgjegjëse të gjinisë femërore ose me rrjedhoren e pashquar të një emri tjetër veprimi (të prejardhur ose të parmë) dhe as të përdoret krahas një emri të tillë, nuk dëshmon për desintaksizimin dhe desubstantivizimin e saj, ashtu siç mendon Gabinski. Në këta togfjalësha arkaikë gjysëm të lirë⁷⁵ emri i veprimit përdoret në një formë të caktuar rasore pa e humbur karakterin emëror. Përndryshe, do të na duhej të pranim se edhe në togfjalësha të tjerë tashmë arkaikë dhe gjysëm të lirë të tipit (qelqi) *ka marrë të krisur*, (ai) *s'ka të sharë*, *ia dha të qarit* emri prejfoljor asnjansë qenka desintaksizuar dhe desubstantivuar, sepse edhe në këta tipa togfjalëshash ai nuk mund të përdoret në të dy trajtat, as në numrin shumës dhe as mund të zëvendësohet me formën përgjegjëse të gjinisë femërore ose me rrjedhoren e një emri tjetër veprimi (të prejardhur ose të parmë), pasi nuk mund të thuhet, p.sh., (qelqi) *ka marrë të krisurit* (ose të krisurën, ose të krisura, ose krisje) etj.

Që forma e tipit *së bëri* në togfjalëshat në shqyrtim nuk është desin-

dhores mund të përdoren edhe me parafjalë) dhe as nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim kuptimi, prandaj s'duhen konsideruar si forma të adverbializuara. Përdorimi i nyjeve **-n** dhe **-s**, pa ndonjë funksion shqes do lidhur me faktin që në funksionin kohor dhe vendor prej kohësh emrat në gjuhën shqipe nuk mund të përdoren në format përgjegjëse të trajtës së pashquar, në rast se nuk paraprihen nga nyja e trajtës së pashquar një ose nga ndonjë përcaktor tjetër.

73) Me sa duket, këtu kemi të bëjmë me një tip ndërtimi të ngjashëm me atë të disa gjuhëve indoevropiane si greqishtja e vjetër, gjermanishtja, rusishtja etj., ku kundrina e drejtë shprehet edhe me anën e rasës gjindore. (Shih Brugmann, Grundriss, II. Band — 1911 —, f. 567 v.)

74) Shih J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, bot. II, 1943, f. 33, si edhe *Analizimi i rasave femërore e zhvillimi historik i tyre*, 1931, f. 7.

Shih edhe shën. 69.

75) Si në këta togfjalësha ashtu edhe në ata të tipave *ka marrë të krisur*, *s'ka të sharë*, *ia dha të qarit*, dy gjymtyrët përbërëse të togfjalëshave të nënshtrohen kufizimeve me karakter semantik dhe gramatikor. Kufizimi me karakter semantik prek gjymtyrën e parë, kurse kufizimi me karakter gramatikor prek gjymtyrën e dytë. Kufizimi me karakter semantik në një masë më të vogël prek edhe gjymtyrën e dytë. Prandaj nuk është fort i saktë pohimi i Gabinskit që forma e tipit *së bëri* në togfjalëshat në shqyrtim mund të formohet nga çdo folje.

taksizuar (pra, as desubstantivuar) provohet edhe nga fakti që, kur e lejon kuptimi i përgjithshëm i togfjalëshit, si p.sh. në togfjalëshat me raporte shkakore, ajo mund të marrë parashtesën pa-, e cila nuk u para-ngjitet kurrë foljevet⁷⁶. Përveç shëmbëllës nga Fjalori i Kristoforidhit (m'u zgërrop barku së pangrani) dhe asaj nga Z. Sako (shkuan ashtu së pathëni), që Gabinski citon në f. 86 dhe 103 të veprës së tij, mund të përmendet edhe kjo: Mos pandeh, zotrote, se edhe në Pezë më 1942 së pagjykuari u përpoqa të pengoj me çdo mjet bashkimin... (Sh. Musaraj, Para agimit, II/424). Por përdorimet e këtij tipi hasen fort rrallë.

Së fundi, desubstantivimin e formës së tipit së bëri Gabinski e argumenton edhe me faktin që kjo formë e ka humbur aftësinë e lidhjevet substantivore, pasi nuk mund të përcaktohet nga një mbiemër, as nga një emër në gjindore, por përkundrazi përcaktohet nga një ndajfolje ose nga një emër në rasën kallëzore (kundrinë). Shoqërimin me ndajfolje dhe marrjen e kundrinës ai e jep edhe si një shenjë të verbalizimit të kësaj forme. Pavarësisht nga qëndrimi jokonsekuent në zbatimin e këtij kriteri në veprën e tij, nuk mund të mos pranohet se këtu kemi të bëjmë me një veçori sintaksore *sui generis*. Ndërsa emrat prejfoljorë asnjans mund të shoqërohen me ndajfolje (por pa e humbur aftësinë për t'u shoqëruar edhe me mbiemra) e mund të marrin edhe kundrina të drejta (por pa e humbur krenjt aftësinë për t'u përcaktuar nga një emër në gjindore), në togfjalëshat në shqyrtim forma e tipit së bëri nuk mund të përcaktohet nga një mbiemër, as nga një emër në rasën gjindore. Sipas mendimit tonë, kjo veçori sintaksore *sui generis* e ka burimin tek fakti që në këta togfjalësha arkaikë gjysëm të lirë forma së bëri përdoret në trajtë të pashquar të paparaprirë nga ndonjë përcaktor (si nyja një etj.) e në një gjendje të tillë çdo emër prejfoljor asnjans në shqipen e sotme, në çfarëdo rase të jetë, nuk shoqërohet me mbiemra ose me emra në gjindore.

Gjithashtu do pasur parasysh se kundrina e drejtë e formës së tipit së bëri, si rregull, shprehet vetëm me emra në rasën kallëzore dhe vetëm rrallë e tek me trajtën e shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë njëjës⁷⁷. Me ndonjë përjashtim shumë të rrallë, ajo nuk përdoret fare me kundrina të zhdrejta⁷⁸.

Në të tilla rrethana na duket i pambrojtshëm pohimi i Gabinskit që forma e tipit së bëri në togfjalëshat në shqyrtim qenka e desubstantivuar, sepse paska marrë tipare foljore.

Edhe pohimi se forma e tipit së bëri mund të sajohet nga çdo folje (f. 119), gjë që, sipas Gabinskit, bashkë me reksionin foljor përbën kushtin e domosdoshëm që një formë e dhënë të konsiderohet si një formë e pashtjellë foljore (f. 130), nuk është i saktë. Para se të bëhej një pohim i tillë, duhej vërtetuar se vetë emri prejfoljor asnjans (përveç formës

76) Në konstruktin participor të tipit pa bërë pjesëza e mohimit pa nuk është në funksion parashtese.

77) Ndërtimet e tipit... e t'u lodhet koka vajzave së më shikuari, që përmend Gabinski (f. 144), më lodhi së më kërkuari një gjë, më mërxiti së më thëni pa të pushuar gjithë po atë fjalë — që gjejmë tek Fjalorthi i Ri i Pano Tases (f. 198) janë të pazakonshme si për përdorimin në funksionin e përcjellores ashtu edhe për përdorimin e trajtës së shkurtër më. Edhe më i pazakonshtëm është përdorimi i trajtës së shkurtër të vetës III (e) në shembullën e f. 94 të Fjalorthit të P. Tases: me ranë legjet e këmbës së e kërkuari.

78) Megjithatë, aty-këtu haset ndonjë përdorim i tillë, i cili nuk është i zakonshëm, si p.sh.: Suat bej Vërdhama... s'kishte pushuar së rëni dhomës kënd më kënd. J. Xoxa, Lumi i Vdekur, III/136 — 7).

në shqyrtim) në shqipen e sotme nuk mund të formohet nga çdo folje. Kurse është një gjë e njohur që këta emra potencialisht mund të formohen nga çdo folje. Prandaj, pa vërtetuar më parë karakterin foljor të formës së tipit *së bëri*, nuk mund të flitet për prejardhjen e saj të drejt-përdrejtë nga folja.

* * *

Përsa i takon dallimit formal të *së bëri* nëpërmjet formës nyjore arkaike *së*, që Gabinski e paraqit si një shenjë të individualizimit material të saj si «një formë e pashtjellë foljore», mjafton të mbahet parasysh se alternanca nyjore *së* ~ *të* nuk del jashtë caqevet të sistemit emëror (duke përfshirë këtu edhe mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e substantivuar). Prandaj nuk ka përse të merret si një shenjë e verbalizimit të formës së tipit *së bëri*, aq më shumë kur formanti *-i* i rrjedhore qëndron i pandryshuar në fund të saj. Dhe kjo do të ishte me të vërtetë një formë foljore e çuditshme që materialisht u individualizua me anë të formës nyjore arkaike *së* dhe në të njëjtën kohë ruan edhe të tjera karakteristika formale të sistemit emëror si mbaresën *-i* të rrjedhore dhe mundësinë për të marrë parashtesën *pa-* (shih më sipër).

Lidhur me formën *s'u bëri*, që, sipas Gabinskit, ndonëse tashti haset shumë rrallë, paska «perspektivë për një zhvillim të mëtejshëm në gjuhë» (f. 142), ne mendojmë se kjo formë e diatezavet pësore-vetëvetore do të ishte zhvilluar pa tjetër⁷⁹, po të kishte kaluar vetë forma e tipit *së bëri* në sistemin foljor, siç pretendon ai. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me raste shumë të izoluara dhe të një përdorimi individual e jo kolektiv⁸⁰.

Aq më pak mund të bëhet fjalë në këto rrethana për krijimin e mundshëm të një forme të kohës së kryer («*së pasuri qenë*»), që, sipas Gabinskit mund të krijohet «në kushte të ngjashme» me ato të formës *t'pasurit klenë* të Z. Skiroit, e cila, siç e vumë në dukje, është një rast i izoluar dhe s'duhet marrë në vështrim.

Për të gjitha këto arsye ne mendojmë se forma e tipit *së bëri* në togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* dhe *u lodha së foluri* as nuk është desubstantivuar, as nuk është shndërruar në një formë të pashtjellë foljore si një paskajore *in statu nascendi*.

Gabinski, siç e vumë në dukje edhe më sipër, ka arritur në këtë përfundim duke u mbështetur edhe në funksionet sintaksore të formës në shqyrtim si edhe në «zhvillimin e mëtejshëm» të këtyre funksioneve. Por edhe në këtë pikë ai, sipas mendimit tonë, nuk ka të drejtë dhe, për më tepër, bie edhe në kundërshtim me vetë kriterin e tij themelor

79) Siç ka ndodhur p.sh. me togjet e gramatikalizuara të tipit *për të bërë* (për *t'u bërë*), *me të bërë* (me *t'u bërë*).

80) Forma *s'u vendosuri*, «Diturija», 1969, nr. 6, f. 83, duket qartë se është përdorur nga një njeri i shkolluar, që ka dashur ta theksojë kuptimin mesor të emrit prejfoljor asnjansës (Ja si shkruan ai: «Po dhe më pastaj s'kanë pushuar Shqipëtarët së vajturi dhe s'u vendosuri n'Itali»).

Edhe për tri rastet e tjera nga Novela, I, II të J. Xoxës (*s'u faluri*, *s'u puthuri*, *s'u shkarkuari*) vlen e njëjta vërejtje. Do pasur parasysh edhe se në romanin tri vëllimesh «Lumi i vdekur» të J. Xoxës nuk haset asnjëherë forma pësore-vetvetore me pjesëzën *u*, sadoqë nuk ka munguar rasti si p.sh.: ... pyeti vëllai i vogël, zgjuar në kohën kur qerrja kish pushuar *së tunduri* e *përkunduri*. U plaka *së mbajturi* mbi kalë të shalëve... Kur mbaroi *së shtruari* sofran... (I/20; III/138; I/91).

për paskajoren. Kjo formë, siç e ka vënë në dukje edhe ai vetë, përdoret rregullisht në funksion kundrinor pas foljesh terminative⁸¹ dhe në funksion shkakor. Funksioni shkakor, siç e ka pohuar edhe vetë ai, (f. 158, shën. 3), në planin gjithëgjyësor nuk përfshihet në sferën e funksionevet të paskajores. Por as funksioni kundrinor nuk del jashtë caqevet të emrit, ndonëse në këtë funksion përdoret dëndur edhe paskajorja. Përsa i takon funksionit gjerundiv, që ai e paraqit si një dukuri të rrallë duke u mbështetur në disa shëmbëlla kryesisht prej Dh. Shuteriqit e ndonjë tjetri (f. 98, 109), do pasur parasysn se në këtë rast kemi të bëjmë me një përdorim individual e jo kolektiv.

Në të tilla rrethana është e pamundur të pajtohemi me parashikimin e Gabinskit, sipas të cilit, në të ardhmen pritet një përhapje e mëtejshme e formës së tipit *së bëri*, duke përfshirë edhe përdorimin e saj në funksione të pavarura (f. 159).

Kundër mendimit të Gabinskit mbi vlerësimin e formës së tipit *së bëri* si një formë të pashtjellë foljore (e aq më shumë si një paskajore *in statu nascendi*) flet edhe një fakt tjetër gjyësor. Format e pashtjella të shqipes të tipit *me punue, pa punuar, duke punuar* si edhe ato më të rejat të tipit *për të punuar, me të punuar*⁸² kanë mundësi të marrin edhe një kryefjalë të ndryshme nga kryefjala e foljes së fjalisë drejtuese. Kurse një mundësi e tillë nuk është zhvilluar tek forma e tipit *së bëri*⁸³.

* * *

Me këtë rast e quajmë të nevojshme të themi dy fjalë edhe mbi arësyen e pretenduar për shtimin e përdorimit të formës së tipit *së bëri*, sidomos në funksionin themelor, në periudhën e pasluftës. Gabinski mendon se ky shtim «mund të ketë lidhje me ndërprerjen relativisht të vonë (fillimi i shek. XX) të ndikimit grek mbi toskërishten (nëpërmjet shkollës dhe kishës ortodokse dhe bilinguizmit të përditshëm në disa rajone) dhe, lidhur me këtë, edhe me mënjanimin e mbështetjes së huaj për lidhoren e shqipes».

Siç shihet, këtu flitet jo më për ndikimin «e substratit grek», por vetëm për ndikimin e greqishtes mbi toskërishten, që qenka ndërprerë vetëm aty nga fillimi i shek. XX. Edhe në këtë rast Gabinski ka bërë një supozim, që nuk mbështetet nga faktet gjyësore të shqipes. Edhe sikur të pranojmë për një çast vlerën e pretenduar foljore të formës së tipit *së bëri*, gjersa kjo është një zhvillim i mbarë shqipes, nuk ka asnjë mbështetje që shtimi i përdorimit të saj në periudhën e pasluftës të lidhet me «ndërprerjen relativisht të vonë (fillimi i shek. XX) të ndikimit të greqishtes... mbi toskërishten».

Por, pavarësisht nga supozime të këtij lloji, që po bëhen të modës tek disa gjuhëtarë të huaj, një gjë është e saktë që togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* dhe *u lodha së foluri* janë duke u përdorur relativisht më shumë në letërsinë shqipe të pasçlirimit. Kjo dukuri, sipas mendimit tonë, e ka burimin në prirjen pothuaj të përgjithshme, që vihet re tek

81) Përdorimi i kësaj forme pas foljesh që tregojnë të filluar ose të vazhduar nuk është një fakt gjyësor i përgjithësuar.

82) Po kështu edhe një të punuar, që haset rrallë në gjuhën letrare.

83) Shëmbëlla e vetme e përmendur nga Gabinski (f. 121) U zgjua së kënduari ne, nxjerrë nga Gramatika e gjuhës shqipe, II. Sintaksa. Tekst për klasat VI-VII, 1959, f. 58, është artificiale, prandaj s'merret në vështrim.

shkrimtarët shqiptarë të pasluftës, për të gjallëruar disa mënyra të shprehuri popullore. Kjo prirje është më e theksuar tek ata shkrimtarë, që i qëndrojnë më afër gjuhës popullore⁸⁴. Madje, mund të pohohet se togfjalëshat në shqyrtim që kanë edhe një ngjyrë arkaicizuese, në shqipen letrare po përdoren më dendur (sidomos togfjalëshi me raport kundrinor⁸⁵) se në gjuhën popullore.

* * *

Së fundi, edhe dy fjalë mbi vjetërsinë e togfjalëshave në shqyrtim si edhe mbi dëndurinë e tyre në të kaluarën. Gabinski na thotë (f. 152, shën. 7) se formën e tipit *së bëri* pas foljesh terminative që nga Buzuku e gjer nga fundi i shekullit XIX e ka ndeshur vetëm 1 herë. Kjo shpjegohet jo vetëm me përdorimin e kufizuar të formës së tipit *së bëri* në përgjithësi, por edhe me numurin e kufizuar të veprave të shekujvet të mëparshëm, që ka shfrytëzuar ai për këtë qëllim. Përveç rastit të Buzukut, që e ka përmendur edhe ai (f. 152), neve na rezultoi se togfjalëshat në shqyrtim i kanë përdorur edhe Budi⁸⁶ e Bogdani⁸⁷ si edhe autorë të tjerë pas tyre.

R é s u m é

A PROPOS DE CERTAINS PROBLEMES DE L'INFINITIF EN ALBANAIS

Dans cet article sont traités certains problèmes concernant l'infinitif en albanais. Y sont examinés les opinions des différents linguistes à ce sujet. Comme point de départ pour sa discussion, l'auteur prend en examen l'ouvrage du linguiste soviétique M. A. Gabinski, intitulée: La naissance de l'infinitif comme processus linguistique balkanique secondaire, parue à Leningrad en 1967. A côté de l'examen critique des opinions exprimées par Gabinski et d'autres linguistes, l'auteur expose aussi ses propres vues sur le problème en question.

La première partie est consacrée à la question de la disparition de l'infinitif dans la plupart des langues des Balkans en général, et en alba-

84) P.sh. Në romanin **Para agimit** të Sh. Musarajt (prej 1.062 faqesh) këto lloj ndërtimesh janë përdorur 36 herë gjithsejt (27 herë me raporte kundrinore dhe 9 herë me raporte shkakore). Në romanin **Lumi i vdekur** të J. Xoxes (prej 831 faqesh) këto lloj ndërtimesh janë përdorur 37 herë gjithsejt (23 herë me raporte kundrinore dhe 14 herë me raporte shkakore). Kurse në romanin **Gjenerali i ushtrisë së vdekur** të I. Kadaresë (bot. I, prej 166 faqesh) gjejmë vetëm 3 togfjalësha të tillë me raporte kundrinore.

85) Por ne nuk pajtohemi me mendimin e Gabinskit (f. 158, shën. 3) që funksioni shkakor i formës së tipit *së bëri* pritet të vijë duke u dobësuar. Në shqipen popullore në këtë funksion ajo, sipas mendimit tonë, përdoret relativisht më dendur se në funksionin kundrinor; por edhe në gjuhën e shkruar ajo nuk haset aq rrallë në këtë funksion. Shih shënimin 84.

86) P.sh.: ... aty e t enjëtenë e madhe me i pasunë mbaruom **neë rrëfyemi...** ... ndërjerë të mos sosnjë **neë foli...**; E ndëvonë mbasi pënduosi të kietë mbaruom e sosunë **neë foli...** (Sp. C. 148, 28, 232)

87) P.sh.: ... e pat këtu aq t'ihunë, sa desh u lodh **së dhimptuni...** (C. Pr., pj. II, III/1/2).

nais, en particulier. Au commencement sont soumis à un examen critique les arguments qu'apporte Gabinski pour infirmer les vues de ces linguistes qui ont expliqué la disparition de l'infinitif dans les langues des Balkans comme un développement parallèle, provoqué par la tendance à éliminer «l'obscurité», «l'abstractivité», etc. des constructions à l'infinitif à l'avantage des constructions au conjonctif. D'après l'auteur Demiraj, les arguments de Gabinski ne résistent pas à la critique. Il fait observer que: 1) La construction au conjonctif résulte plus claire que celle à l'infinitif, c'est pourquoi elle a été généralisée non seulement dans les langues des Balkans, mais aussi dans d'autres langues, notamment quand le sujet du deuxième verbe est différent de celui du verbe régent; 2) L'opinion que dans les langues balkaniques on remarque que la tendance à éliminer le bifactivisme pourrait servir à appuyer la vue de Gabinski si celui-ci aurait prouvé tout d'abord que cette tendance est plus ancienne que celle de la substitution de l'infinitif par le conjonctif et que ce dernier phénomène s'est produit en opposition avec la tendance en question; 3) Les cas évoqués par Gabinski en démonstration de sa thèse (alb. duhet të bëj, roum. trebuie să fac, gr. πρέπει να κάνω alb. mund të bëj; le futur à do) ou bien sont rencontrés en dehors des Balkans comme en français (il faut faire) et italien (bisogna fare), ou bien sont des conséquences de la prononciation à liaison, où une part décisive a eu l'accent de syntagme (mund të bëj, do të bëj).

Les arguments qu'invoque Gabinski contre la thèse que l'origine de la disparition de l'infinitif dans les langues balkaniques doit être cherchée dans le grec, sont en général convainquants. Il y a lieu d'ajouter à ce propos que l'influence du grec sur les langues balkaniques a été surévaluée pour ce qui est de la structure grammaticale.

Au contraire, l'hypothèse de Gabinski que le point de départ de ce phénomène doit être cherché «dans quelque langue ancienne de la partie S.-E. des Balkans, c'est-à-dire dans l'une des variétés du thrace», est insoutenable. Cette hypothèse, qui se rapproche sensiblement de celle de Weigand, s'appuie sur trois conjectures, également insoutenables: D'après lui, le thrace (ou le dacomyzien) peut être considéré comme une langue qui n'a pas possédé l'infinitif, si l'hypothèse de V. Georgiev, d'après lequel l'albanais serait le continuateur du dacomyzien serait prouvée et si l'hypothèse du même Gabinski que le type me ba a été, à son origine, un gérondif, formé à l'aide du préfixe me et d'un nom de provenance participiale serait confirmée. A ce propos, on doit toujours tenir compte que tant l'hypothèse de Georgiev que celle de Gabinski restent du domaine des conjectures, pour autant qu'elles n'ont pas un soutien ni historique ni linguistique.

Dans ces circonstances, l'auteur de l'article, Demiraj, croit qu'il serait plus plausible à retourner à l'hypothèse de la polygenèse de la disparition de l'infinitif dans les langues balkaniques.

Dans la première partie de l'article l'auteur examine aussi les questions si l'albanais a eu ou non un infinitif proprement dit, comparable sous l'aspect structurel à l'infinitif des autres langues indoeuropéennes et si l'infinitif du type me ba a été aussi du domaine du dialecte tosqe. Tant pour la première que pour la deuxième question il y a, comme on sait, des opinions contraires.

Sur la première question, plusieurs savants comme Hahn, G. Meyer, Kr. Sanfeld, et d'autres ont exprimé l'opinion que l'albanais n'a pas eu

un infinitif proprement dit. Gabinski aussi nie catégoriquement que l'albanais ait connu un infinitif plus ancien que celui du type *me ba*. Au contraire Pedersen et E. Çabej ont soutenu le contraire, mais sans développer plus loin leurs opinions. Ce qui plus est, il semble que, plus tard, Pedersen ait changé d'opinion. Sur la deuxième question, Pedersen s'est exprimé avec des réserves; au contraire, E. Çabej et Gabinski ont affirmé catégoriquement, le premier que le tosque n'a pas eu et le deuxième que le tosque a eu l'infinifitif du type *me ba*.

Compte tenu que tant la forme du type *me ba* que celle du type *për të bërë* ont des valeurs d'infinifitif, et, en telles, sont synonymes au conjonctif, l'auteur de cet article aboutit aux conclusions suivantes: 1) Si l'albanais n'a pas eu un infinitif plus ancien que celui du type *me ba* (de provenance participiale), alors il ne serait point question de la substitution de l'infinifitif par le conjonctif, mais d'un phénomène contraire. 2) Si aussi le tosque a eu l'infinifitif du type *me ba*, alors il faudrait admettre que dans ce dialecte a eu lieu, dans une période plus ancienne, la tendance de la substitution de cet infinitif avec le conjonctif, tandis que plus tard, par la création de la forme du type *për të bërë* a eu lieu une tendance contraire. Dans ces circonstances, à l'auteur paraît possible que l'albanais ait connu un infinitif plus ancien que celui du type *me ba*.

Ensuite, l'auteur soumet à une analyse critique l'opinion et les «arguments» de Gabinski, d'après lequel l'infinifitif du type *me ba* soit disparu en tosque sous l'influence du «substrat grec» (!). Il fait ressortir que des données et des conjectures de Hahn, Seliščev et Desnickaia, auxquelles se réfère Gabinski pour la démonstration de sa «thèse», on ne peut tirer aucunement la conclusion sur le prétendu «substrat grec» de la Toskérie. Tout au contraire, les données de ces auteurs permettent d'aboutir à une conclusion tout à fait opposé, et précisément à celle que durant les âges ce n'est point la langue albanaise celle qui a poussé le grec plus au midi, mais qu'au contraire c'est le grec qui a avancé plus au nord, au dépens de l'albanais. Donc, la conjecture de Gabinski sur le prétendu «substrat grec» qui aurait été à l'origine de la disparition de l'infinifitif au tosque est dénuée de toute validité historique et linguistique et ne peut être considérée qu'une invention à soutenir son hypothèse sur la disparition de l'infinifitif dans les langues balkaniques sous l'influence du substrat thrace.

Dans la deuxième partie de cet article l'auteur s'occupe de la question des critères qu'il faut suivre en vue de déterminer le deuxième infinitif de la langue albanaise. Après avoir fait ressortir l'attitude contradictoire de Gabinski sur la détermination des catégories grammaticales du nom et du verbe, il critique sa vue que la distinction de la diathèse, de l'aspect, du temps relatif, ainsi que l'association à adverbe, la transitivité et l'usage absolu ne sont point des traits du verbe, étant donné que dans quelques langues ces traits les possédaient aussi quelques types de noms verbaux. L'auteur fait quelques observations aussi sur la méthode appliquée par Gabinski en vue de déterminer l'existence du deuxième infinitif de l'albanais.

Ensuite l'auteur exprime son opinion sur les critères de détermination du deuxième infinitif de l'albanais. D'après lui, un groupe prépositionnel (préposition + nom) ou bien une forme nominale doit, pour passer à la catégorie de l'infinifitif, être verbalisée d'abord et à cela doivent concourir les deux conditions suivantes: 1) la désubstantivation du grou-

pe prépositionnel ou de la forme nominale; 2) l'attribution des traits verbaux: a) catégories grammaticales du verbe (diathèse, etc.); b) rection verbale (complément d'objet direct ou indirect exprimé également dans les formés indéterminés des pronoms personnels; l'attribution d'un sujet particulier ainsi que l'association avec adverbes au lieu des adjectifs), c) l'emploi avec des particules négatives caractéristiques aux formes verbales.

Mais, pour passer dans la catégorie de l'infinitif, le groupe (ou la forme) verbalisée doit avoir acquis la possibilité d'être employée en fonctions syntaxiques, qui rentrent dans la sphère d'usage de l'infinitif, y comprises, sans nul doute, aussi les fonctions de sujet et de prédicat.

La troisième partie de l'article porte sur la valeur du groupe de type për të bërë. De cette question l'auteur s'est occupé aussi dans une communication tenue devant la I^{re} Conférence d'Etudes albanologiques (1962) ainsi que dans un autre travail encore inédit. Il est d'avis que le groupe du type për të bërë a perdu les traits d'un groupe prépositionnel. Le nom déverbatif neutre est désubstantivé, en perdant ainsi les liens syntaxiques propres aux noms. Ce groupe, à différence de maints autres groupes prépositionnels passés dans la classe des adverbes (ex. me të përtuar, etc.), a assumé aussi les traits verbaux (v. les notes de la partie II), c'est-à-dire est verbalisé. Il s'emploie dans des fonctions qui rentrent dans la sphère d'usages de l'infinitif: dans la fonction finale, attributive, prédicative, comparative, comme partie composante du futur, dans des constructions tautologiques, et, parfois, aussi en fonction subjective et objective. Etant donné que le groupe en question n'est pas usité dans toutes les fonctions de l'infinitif, Demiraj le considère comme une forme analytique à valeur d'infinitif de fonction syntaxique limitée. Il fait ressortir que ce type d'infinitif est de tout l'albanais et non point du seul tosqe, comme l'ont affirmé plusieurs linguistes dans le passé.

Par conséquent, l'auteur réfute l'opinion de Gabinski qui admet la désyntaxisation et la valeur infinivale du groupe de type për të bërë seulement quand il est usité dans des fonctions qui en albanais ne sont pas exprimés par la préposition për. A ce propos, Demiraj fait observer que, quoique dans un groupe prépositionnel, le rôle de la préposition en tant qu'expression de rapport syntaxique soit important, la fonction syntaxique est effectuée par tout le groupe, où le nom est la principale partie constituante. C'est pourquoi, la désyntaxisation d'un groupe préposition+nom est, en dernière analyse, la désyntaxisation du nom lui-même, qui perd en ce cas les particularités morphologiques et les liens syntaxiques qui lui sont propres. De même, Demiraj a fait ressortir que dans l'estimation catégoriale du groupe de type për të bërë Gabinski a identifié le critérium de désyntaxisation et de verbalement de ce groupe avec celui de la détermination s'il a pris ou non la valeur d'un infinitif. Ce sont deux choses différentes, quoique intimement rattachées entre elles, du fait que la première conditionne la deuxième.

Dans la quatrième partie de l'article il est question de l'appartenance catégoriale de la forme du type së bëri dans les groupes de mots du type mbarova së foluri et u lodha së foluri. Gabinski a fait effort à démontrer que cette forme est désubstantivée et verbalement parce que: 1) elle est usitée dans des fonctions qui en albanais contemporain ne sont pas exprimées à l'aide de l'ablatif sans préposition; 2) ne peut pas être usitée au défini, ni au pluriel et ne peut non plus être substituée par un autre nom d'action et ni être usitée à côté d'un tel nom; 3) ne peut être déterminée par

un adjectif ou par un nom au génitif; 4) elle a pris des traits verbaux: l'attribution du complément à l'accusatif et l'association à adverbe sont devenues des normes; 5) elle a été «individualisée» matériellement au moyen de l'article sè (à différence de l'article të du nom déverbal neutre à ablatif) et au moyen de la distinction sporadique de la diathèse non active à l'aide de la particule pronominale u. Il aboutit à la conclusion que la forme sè bëri peut être considérée un infinitif in statu nascendi.

L'auteur Demiraj n'admet pas l'opinion de Gabinski pour les raisons suivantes: 1) Aussi en albanais contemporain l'ablatif sans préposition est encore usité, quoiqu'il rarement, tant dans la fonction causale que dans celle objective (ex. plasa vape; s'kam parë asi njeriu); 2) Le fait qu'il est usité au seul ablatif indéfini singulier et ne peut être substitué par un autre nom d'action (dérivé ou primitif), et non plus être usité à côté d'un tel nom, n'atteste point de sa désyntaxisation et de sa désubstantivation. On a affaire en ce cas de groupes de mots archaïques semi-libres, où le nom déverbal neutre est usité dans une forme de cas donné (à confronter avec d'autres groupes de mots semi-libres du type *qelqi ka marrë të krisur, ia plasi të qarit*, etc.); 3) L'impossibilité d'être déterminé par un adjectif ou par un nom au génitif est conditionnée par des circonstances que dans ces groupes archaïques de mots semi-libres, la forme du type sè bëri est usitée à l'indéfini précédé par l'article një ou par un autre déterminant; dans telle circonstance, tout nom déverbal neutre en albanais contemporain, dans tout cas qu'il soit, ne peut être associé à des adjectifs ou des noms au génitif; 4) Il ne peut être question de rection verbale, pour autant que la forme en question ne peut s'attribuer régulièrement des compléments d'objet ou de régime exprimés aussi par les formes atones des pronoms personnels. On doit tenir compte aussi du fait qu'elle ne peut s'attribuer un sujet propre, tout comme les autres formes indéclinables de l'albanais; 5) La prétendue «individualisation matérielle» de la forme du type sè bëri au moyen de l'article archaïque sè est insoutenable du fait que l'alternance de l'article sè ~ të ne débordé guère les limites du système nominal. Au contraire, la forme du type s'u bëri représente un abus qu'on ne trouve que très rarement chez quelque auteur isolé; 6) Quand le permet le sens général du groupe de mots, la forme du type sè bëri peut s'attribuer aussi le préfixe pa-, qui n'est jamais préfixé aux verbes; 7) Aussi les fonctions syntaxiques (notamment objectives et causales) de cette forme ne militent pas en faveur de la vue de Gabinski.